

Ne vijim te komunikimit lidhur me kerkesen tuaj, po ju percjell raportin mbi procesin e konsultimit publik per Ligjin "Per Mbrojtjen e Pakicave Kombetare ne Republiken e Shqiperise" ,i cili ka qene i vetmi per periudhen 2016-2017.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

RAPORT MBI PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK

Në kuadrin zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Kushtetuta, Konventa Kuadër e Këshillit të Europës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, si dhe bazuar në rekomandimet e Komitetit Këshillues të kësaj konvente, Këshilli i Ministrave ndërmoi iniciativën për hartimin e projektligjit për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Hartimi i këtij projektligji ka qenë një angazhim konkret i qeverisë shqiptare në drejtim të përmbushjes së 5 prioriteteve të rekomanduara nga Komisioni Evropian një ndër të cilët është “përmirësimi i kuadrit ligjor dhe politikave për mbrojtjen e pakicave”.

Projektligji është produkt i një bashkërendimi të gjerë ndërinstitucional, me përfshirjen aktive të Komitetit Shtetëror për Minoritetet, dhe duke iu nënshtruar një konsultimi gjithëpërfshirës me përfaqësuesit e pakicave kombëtare. Hartimi i projektligjit është konsultuar hap pas hapi me ekspertizën më të mirë të fushës të ofruar nga Këshilli i Europës, është bazuar në modelet më të mira analoge europiane duke pasur parasysh dhe situatën e pakicave në Republikën e Shqipërisë.

Me qëllim hartimin e projektligjit mbi pakicat dhe zhvillimin e një procesi të gjerë të konsultimit për pakicat janë zhvilluar takime periodike të grupit ndërinstitucional të punës me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të pavarura ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr.121, datë 27.7.2016 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e projektligjit “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në SH-së”.

Projektligji është hartuar nga grupi ndërinstitucional i punës ngritur me urdhër të Kryeministrit nr.121, datë 27.7.2016, në të cilin MPJ ka rol koordinues dhe i është përcjellë për mendim të gjitha ministrive të linjës.

Ministrinë janë shprehur në parim dakord lidhur me nevojën e hartimit të këtij projektligji dhe një pjesë e tyre kanë bërë sugjerime, vërejtje dhe propozime të cilat janë reflektuar si më poshtë:

Ministria e Kulturës, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Integritit Evropian, Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës janë shprehur dakord dhe pa sugjerime, komente apo vërejtje.

Ministria e Drejtësisë

Sugjerimi 1 u reflektua në relacion.

Sugjerimi 2 (neni 12, pika 2 dhe 14) u reflektua pjesërisht, pasi vlerësojmë se kjo çështje do të rregullohet me akte nënligjore siç shprehet edhe Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Sugjerimi 3 (neni 14) vlerësojmë se nuk qëndron pasi formulimi aktual në projektligj është në përputhje me nenin 11 të Konventës Kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCNM).

Sugjerimi 3.1 (neni 14, pika 6) vlerësojmë se nuk qëndron pasi gjykojmë se Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore sugjeron rregullimin me akt nënligjor të përdorimit të gjuhës së pakicës bë bashkitë me popullsi mbi 20% të pakicës kombëtare. Sugjerimet për nenet 10, pika 3 dhe 11, pika 2 u reflektuan në projektligj.

Sugjerimi 4 (neni 17) dhe 4.1, për qartësimin e statusit të Komitetit u reflektua në projektligj.

Sugjerimi 5 (neni 20) mbi përcaktimin e kriterëve të qarta dhe objektive për sa i përket përdorimit dhe administrimit të Fondit nga Komiteti, është reflektuar në shtojcën 2 bazuar në sugjerimet e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS), ka paraqitur sugjerime lidhur me nenin 12 e drejta e arsimimit në gjuhën e pakicës.

Lidhur me nenin 12 pika 2, MAS sugjeron heqjen e termave kërkesë e njaftueshme dhe numër thelbësor pasi përcaktohen nga aktet ligjore përkatëse për hapjen e klasave të pakicave.

Në lidhje me kriteret/procedurat e zbatimit të kësaj dispozite MAS sugjeron se nuk është e nevojshme të detajohen në projektligj, por do të rregullohen me aktet nënligjore. Reflektuar në projektligj, neni 12, pika 3 dhe 4.

Sa i përket niveleve të mësimit të gjuhës së pakicës dhe niveleve të arsimit në gjuhën e pakicës (arsimi i detyrueshëm, i mesëm apo i lartë) bazuar në nenin 20 pika 1 të Kushtetutës MAS konsideron që nivelet e arsimit në gjuhën e pakicave t'u referohen të drejtave që u garantohen shtetasve me kombësi shqiptare por sipas kërkesave të pakicave kombëtare.

Bazuar në sa më sipër, janë reflektuar sugjerimet e MAS, lidhur me nenin 12, pika 2, konkretisht lidhur me sigurimin e mundësive të personave që u përkasin pakicave në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ato banojnë tradicionalisht për të mësuar ose marrë mësim në gjuhën e pakicës në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit. Gjithashtu janë reflektuar sugjerimet e mësipërme edhe në pikat 3 dhe 4 të nenit 12.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Reflektuar sugjerimi 1 (neni 2, pika 1) mbi riformulimin e togfjalëshit “mbrojtja e identitetit dallues të pakicave kombëtare”.

Sugjerimi 2 (neni 3) që përkufizimi i pakicës kombëtare të riformulohet duke pasur parasysh Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.52/2011 mbi përdorimin e konceptit “kombësi” në legjislacionin për gjendjen civile, sqarojmë se termi “pakicë kombëtare” është i parashikuar shprehimisht në nenin 20 të Kushtetutës, si dhe i referohet terminologjisë së Konventës Kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Neni 3 i projektligjit nuk synon të krijojë të drejta dhe detyrime ndërmjet një personi me kombësi të ndryshme nga ajo shqiptare dhe shtetit shqiptar, por ka si qëllim përcaktimin e karakteristikave dalluese të një personi që i përket një pakice kombëtare në raport me pjesën tjetër të popullsisë. Nga përmbajtja e nenit 3 nuk rezulton përdorimi i termi “kombësi”.

Sugjerimi 3 (neni 5), mbi saktësimin e terminologjisë “regjistrimet periodike të popullsisë” në kuptimin që regjistrimi duhet t’i referohet censusit si veprimtari e pavarur, sqarojmë se Kushtetuta dhe Konventa Kuadër parashikojnë të drejtën e personave që u përkasin pakicave kombëtare për t’u vetë-identifikuar ose jo si të tillë në çdo moment dhe jo vetëm në regjistrimet periodike të popullsisë (neni 20). Vlerësojmë se për zbatimin e dispozitave të këtij ligji sa i përket gëzimit individual të të drejtave të personave që i përkasin pakicave nevojitet që këta persona të vetë-identifikohen pranë institucioneve publike që garantojnë gëzimin e këtyre të drejtave, si psh. për ushtrimin e së drejtës së arsimimit në gjuhën amtare, apo të drejtën e përdorimit të gjuhës. Pikërisht neni 5, pika 2 i projektligjit synon adresimin e çështjeve të mësipërme.

Sugjerimi 4 (neni 6, pika 1) mbi identifikimin e institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor që do të mbledhin të dhëna në lidhje me identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare, vlerësojmë se nuk mund të listohen të gjithë institucionet qendrore dhe vendore që mbledhin të dhëna në lidhje me identifikimin e pakicave, por është e kuptueshme që bëhet fjalë për çdo institucion i cili ngarkohet me zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Ndërkohë pika 2 e këtij neni synon përcaktimin me akte nënligjore të kriterëve dhe procedurave, e rrjedhimisht edhe institucioneve për mbledhjen e të dhënave. Parashikimet në nenin 6 janë në përputhje edhe me nenin 35 të Kushtetutës i cili parashikon rastet e mbledhjes, përdorimit dhe bërjes publike të të dhënave rreth personit, që bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.

Sugjerimi 5 (neni 14, pika 1) se legjislacioni përkatës nuk e parashikon përdorimin e emrit dhe mbiemrit të personave që u përkasin pakicave në gjuhën e tyre, duke iu referuar Kodit të Familjes, Kodit Civil dhe ligjit për gjendjen civile, vlerësojmë se formulimi i kësaj dispozite bazohet në nenin 11 të Konventës Kuadër, duke qenë një ndër të drejtat thelbësore për ruajtjen e identitetit të dallueshëm të pakicave. Në bazë të nenit 116 të Kushtetutës si marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj Konventa Kuadër ka epërsi mbi legjislacionin e brendshëm. Pikërisht përfshirja e kësaj dispozite synon rregullimin e ushtrimit të kësaj të drejte dhe në këtë kuptim duhen bërë ndryshimet përkatëse në legjislacionin e brendshëm.

Sugjerimi 6 (neni 14, pika 3) mbi riformulimin e kësaj pike bazuar në VKM-në nr.446, datë 5.3.2008 “Mbi përcaktimin e specifikimeve teknike të tabelave të emërtimeve të parqeve, shesheve, bulevardeve, rrugëve, numërtimeve të ndërtesave”, sqarojmë se ky akt parashikon specifikimet teknike të tabelave dhe jo mënyrën e realizimit të së drejtës për të patur emërtimet dhe shenjat topografike në gjuhën e pakicave. Vetë Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore sugjeron nxjerrjen e një akti nënligjor në zbatim të kësaj pike për përdorimin e gjuhës së pakicave në emërtimet e toponimeve.

Reflektuar sugjerimi 7 (neni 14, pika 4) mbi parashikimin me akt nënligjor të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organ që administron zgjedhjet, me synim garantimin dhe respektimin e parimeve, të drejtave dhe garancive kushtetuese dhe ligjore për zhvillimin e tyre.

Sugjerimi 8 (neni 19, pika 2) reflektuar pjesërisht, pasi sugjerimi “mbi bazën e rotacionit të përfaqësuesve të pakicave çdo vit” konsiderohet kohëzgjatje e pamjaftueshme nga Komiteti Shtetëror për Minoritetet, përfaqësuesit e pakicave, ekspertët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile. Ministri për Çështjet Vendore (MÇV)

Në lidhje me projektligjin, konkretisht vetë-identifikimin e çdo individi për përkatësinë ose jo në një pakicë kombëtare (neni 5), vlerësohet se ky vetëdeklarim mund të bëhet vetën në procesin e realizimit të censurit, duke qenë pjesë e formularit përkatës. Praktikisht nuk ekziston asnjë mundësi për vetëdeklarimin, duke qenë se ligji për Gjendjen Civile nuk e lejon.

Në lidhje me përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore MÇV shprehet se si njësi e qeverisjes vendore do të konsiderohet për vlerësimin e përqindjes së pakicave (mbi 20%) do të konsiderohet Bashkia. Ky sugjerim është reflektuar në nenin 14, pikat 2 dhe 3.

MÇV vlerëson si të nevojshme nxjerrjen e akteve nënligjore pas miratimit të ligjit, në aspektin e qeverisjes vendore, konkretisht Vendim të Këshillit të Ministrave për saktësimin e mënyrës së përdorimit të gjuhës së pakicave në Bashkitë me popullsi minoritare më shumë se 20%, si dhe të një VKM mbi përdorimin e gjuhës së pakicave në sinjalistikën dhe emërtimet e toponimeve.

Sugjerimet e mësipërme janë reflektuar në nenin 14, pika 2, pika 3 të projektligjit.

Ministria e Financave shprehet se projektligjit i mungon analiza e kostove eventuale të që rrjedhin nga propozimet e tij, e cila është kompetencë e institucioneve përgjegjëse për zbatimin në praktikë të neneve përkatëse që kanë të bëjnë me kurrikulat, Komitetin e Pakicave Kombëtare dhe Fondin e Pakicave Kombëtare, të cilat janë reflektuar me paraqitjen e analizës përkatëse nga KSHM.

Sugjerimi 2 (neni 10, pika 3) u reflektua në projektligj.

Në lidhje me sugjerimin Sugjerimi 3 (neni 12, pika 2 dhe 4) Ministria e Arsimit dhe Sportit si institucioni kompetent ka bërë një përlllogaritjen e kostove të mundshme si rrjedhojë e përgatitjes së kurrikulave specifike për pakicat, krijimin dhe funksionimin e ambienteve për zhvillimin e mësimin në gjuhën e pakicës dhe krijimit të mundësive të nevojshme si me poshtë:

- Fonde për hartimin dhe miratimin e kurrikulës specifike dhe programet për pakicat kombëtare planifikohen mesatarisht rreth 2.5-3 milionë lekë/vit;
- Fonde për trajnime të mësuesve të pakicave kombëtare planifikohen mesatarisht rreth 5-7 milionë lekë në vit;
- Fonde për subvencionimin e teksteve shkollore për pakicat kombëtare planifikohen mesatarisht rreth 15-20 milionë lekë/vit;
- Fonde për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar që japin mësim në institucionet arsimore për nxënësit e fëmijëve të pakicave kombëtare;
- Fonde për transportin e punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimin fillor, arsimin të mesëm të ulët si dhe arsimin të mesëm të lartë të institucioneve arsimore publike që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, larg vendbanimit të përhershëm të tyre në largësinë mbi 5 km dhe kthehen brenda ditës në vendbanim;

Sugjerimi 4 (neni 17, pika 1) mbi ngritjen e një strukture administrative, Komitetit të Pakicave Kombëtare, është reflektuar duke u bazuar në përlogaritjet e bëra nga Komiteti Shtetëror (shih shtojcën 1. të këtij relacioni).

Ministria e Financave, duke e prezumuar këtë projektligj si iniciativë të MPJ-së vë në dukje se krijimi i kësaj strukture nuk është parashikuar në buxhetin e vitit 2017. Ndërkohë, një strukturë e tillë nuk do të funksionojë në varësi të MPJ-së por të Kryeministrit.

Sugjerimi 5 (neni 20), është reflektuar në shtojcën 2 të këtij relacioni bazuar në sugjerimet e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve.

Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, ka paraqitur kontributet dhe propozimet e tij gjatë procesit të hartimit të këtij projektligji duke qene tepër aktiv në aktivitetin e Grupit Ndërinstitucional të Punës. Janë marrë parasysh në hartimin e projektligjit shumë prej propozimeve të KSHM veçanërisht sa i përket:

- evidentimit në ligj të pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë,
- mos diferencimit të pakicave ne dy grupe por vetëm duke i identifikuar si pakica kombëtare;
- forcimit të kompetencave të Komitetit për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe mbështetjes financiare të aktivitetit të tij.

Kontributet e institucioneve të tjera

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit janë ftuar dhe kanë marrë pjesë në Grupin ndërinstitucional të Punës gjatë procesit të hartimit dhe konsultimit të projektligjit edhe përfaqësuesit e Kuvendit, institucioneve të pavarura (Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit), Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, Autoriteti i Mediave Audio-Vizive, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Radio-Televizioni Publik Shqiptar, Akademia e Shkencave.

Gjithashtu edhe institucionet e sipërpërmendura kanë paraqitur kontribut dhe sugjerimet e tyre gjatë këtij procesi.

- Procesi i konsultimit publik

Gjithashtu, në kuadër të procesit të konsultimit, gjatë vitit 2016 janë zhvilluar dy tryeza të rumbullakëta, konkretisht një tryezë e veçantë me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfaqësues të shoqatave të pakicave, shoqërisë civile, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, me qëllim shkëmbimin e mendimeve dhe evidentimin e problematikave dhe çështjeve mbi pakicat, me qëllim adresimin e tyre në projektligj. Në muajin tetor 2016 u zhvillua Konferenca konsultuese me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të pavarura, përfaqësues të organizmave ndërkombëtare, trupit diplomatik, ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, akademikë, shoqatave të pakicave, shoqërisë civile.

Në muajin janar 2017 u zhvillua takimi konsultativ mbi projektligjin “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me pjesëmarrjen e Kryetarëve të Bashkive, Prefektëve të Qarqeve dhe anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e projektligjit, si dhe përfaqësues së Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, Delegacionit të BE-së, Prezencës së OSBE-së.

Projektligji i është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, duke u publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme, me një afat 20 ditor, i cili për shkak të rëndësisë së projekt-aktit u zgjat edhe për 20 ditë të tjera, me qëllim gjithëpërfshirjen e aktorëve të interesuar me marrjen e sa më shumë komenteve e rekomandimeve të vlefshme.

Në përfundim të procesit të konsultimit konstatojmë se janë paraqitur komente nga rreth 20 shoqata përkatësisht të pakicave greke, maqedonase, serbe, malazeze, rome, të komunitetit egjiptian dhe atij boshnjak, si dhe nga shoqëria civile, ekspertë dhe akademikë. Kryesisht komentet e shoqatave fokusohen në njohjen ligjore, listimin e tyre, shmangien e dallimeve në dy kategori, vetë-identifikimin, përdorimin e gjuhës dhe garantimin e së drejtës së arsimimit në gjithë territorin, përfaqësimin në jetën publike dhe politike, simbolet, fondin e posaçëm, funksionimin, kompetenca të detajuara dhe pavarësinë e Mekanizmit zbatues të ligjit.

Gjatë procesit të hartimit të këtij projektligji është konsultuar dhe mbajtur parasysh edhe ekspertiza ndërkombëtare e Këshillit të Evropës dhe Komisionerit të Lartë për Pakicat kombëtare të OSBE-së.

Ekspertiza europiane e përfshirë në procesin e konsultimit e ka vlerësuar pozitivisht këtë projektligj, prej të cilave:

“Dispozitat e projektligjit janë në përputhje të plotë me standardet europiane të vendosura nga Konventa Kuadër të Këshillit të Europës për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe Komisioni i Venecias. Ai zgjidh përfundimisht problemin e përkufizimit të pakicave kombëtare në Republikën ku deri më sot ekzistonte kategorizimi në pakica kombëtare dhe në pakica etno-linguistike apo etno-kulturore. Gjithashtu, ai garanton ushtrimin e të drejtave të pakicave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të drejtat specifike në njësitë e pushtetit vendor ku pakicat përbëjnë një numër thelbësor duke aplikuar pragun prej 20% i cili përbën një standard për vendet e zhvilluara europiane.

Neni	Argumenti
<p style="text-align: center;">Neni 1 Objekti</p> <p>Ky ligj rregullon ushtrimin e të drejtave të personave që i përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar me ligjin nr.8496, datë 3.6.1999, dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut ku</p>	<p>Neni ka karakter të përgjithshëm dhe referon objektin/fushë që rregullon.</p>

Republika e Shqipërisë është palë.	
<p style="text-align: center;">Neni 2 Qëllimi</p> <p>1. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen identitetit dallues të pakicave kombëtare si një komponent thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit.</p> <p>2. Në ushtrimin e këtyre të drejtave, personat që i përkasin pakicave kombëtare duhet të respektojnë shtetin ligjor, tërësinë territoriale dhe sovranitetin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Neni përcakton synimin për të rregulluar të drejtat specifike të pakicave në raport me pjesën tjetër të popullsisë. Garanton parimi bazë të mosdiskriminimit. Është hartuar në konsultim dhe me formulimin e sugjeruar kulzulenca e KiE si dhe nga Komiteti Shtetëror për Minoritetet.</p> <p>Formulimi garanton që ushtrimi i të drejtave të pakicave duhet të jetë gjithmonë në përputhje me rendin kushtetues.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimi</p> <p>1. Një pakicë kombëtare është një grup shtetasish shqiptarë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare, ose tradicionale, dhe të cilët janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar së bashku, identitetin e tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar, ose tradicional.</p> <p>2. Në kuptimin e këtij ligji pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, vllahe/arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe.</p> <p>3. Njohja formale e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë bëhet me ligj, me iniciativë të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për punët e brendshme, bazuar në kërkesën e përfaqësuesve të pakicave kombëtare dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe nenet 5 e 6 të këtij ligji.</p>	<p>Neni është formuluar duke pasur parasysh karakteristikat bazë që duhet të gëzojë një pakicë kombëtare. Në përputhje me terminologjinë kushtetuese (neni 20) përdoret në mënyrë të unifikuar vetëm koncepti i pakicës kombëtare duke njohur si të tilla të gjitha pakicat në RSH që deri më sot ndaheshin në kombëtare dhe etno-kulturore ose etno-linguistike. Formulimi është bazuar dhe në sugjerimin e konsulencës së KiE.</p> <p>Evidentimi i 8 paicave kombëtare është bërë duke pasur parasysh ekzistencën e këtyre pakicave në territorin e RSH që me fillimet e shtetit të pavarur shqiptar, evidentimin në censuset periodike të zhvilluara në shtetin shqiptar, vetë-deklarimin dhe vlerësimet në terren të organeve të pushtetit vendor. Neni nuk krijon diskriminim bazuar në numrin e pretenduar apo të evidentuar të secilës pakice.</p>

	<p>Njohja e pakicave kombëtare bazohet, sipas ligjit, jo vetë në kriterin e vetëdeklarimit (subjektiv) po dhe duke pasur parasysh elementët (objektivë) si origjina familjare e cila evidentohet në historikun e regjistrave të Gjendjes Civile. Për këtë arsye projektligji përkatës duhet të propozohet nga MPB që ka në varësi DP të Gjendjes Civile.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Ushtrimi i të drejtave</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të zgjedhë lirisht që të trajtohet ose jo si i tillë, duke mos pasur asnjë disavantazh nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që janë të lidhura me këtë zgjedhje. 2. Personat që u përkasin pakicave kombëtare i ushtrojnë të drejtat dhe gëzojnë liritë e garantuara me këtë ligj, në mënyrë individuale dhe në komunitet me të tjerët, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. 	<p>Formulimi është bërë duke pasur parasysh dispozita përkatëse të Konventës Kuadër. Vlerësuar pozitivisht nga ekspertiza e KiE. E rëndësishme të theksohet që të drejtat e pakicave sanksionohet se garantohen në të gjithë territorin.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 E drejta e vetë-identifikimit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çdo person ka të drejtë të deklarojë përkatësinë në një pakicë kombëtare bazuar në të drejtën e vetë-identifikimit sipas parashikimeve të ligjit për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë së Republikës së Shqipërisë dhe në rastet e parashikuara në këtë ligj. 2. Askush nuk mund të detyrohet të zbulojë të dhëna në lidhje me përkatësinë e tij/saj në një pakicë kombëtare dhe as përkatësinë e tij/saj etnike, gjuhësore ose fetare, me përjashtim të rasteve kur ky zbulim të dhënash është i nevojshëm për ushtrimin e të drejtave të parashikuara në nenet 3, 10, 11, 12, 13, 14 të këtij ligji. 	<p>Formulimi bazohet në terminologjinë e Konvetës Kuadër duke qenë se vetëdeklarimi është elementi parësor (por jo të vetëm) që bën lidhjen e individit me një komunitet që konsiderohet si pakicë kombëtare. Bazuar dhe në sugjerimin e ekspertizës së KiE.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 6 Mbledhja e të dhënave</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në përputhje me nenit 5 pika 2 dhe të legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, për garantimin e të drejtave të pakicave, institucionet publike në nivel qendror dhe vendor mbledhin të dhëna në lidhje me identifikimin e personave që i përkasin pakicave kombëtare. bazuar në të drejtën e vetë-identifikimit të këtyre personave dhe në dokumentacionin e Gjendjes Civile. 2. Kriteret dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave të parashikuara në pikën 1 miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. 	<p>Dispozita siguron hapësirën e domosdoshme për mbledhjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës duke shmangur situatat diskriminuese apo abuzive ndaj individëve që i përkasin pakicave për shkak të kësaj përkatësie. Dispozita mbetet për t'u shtjelluar me akte nënligjore. Për dispozitën nuk ka pasur komente kundër dhe është në përputhje me frymën e Konventës Kuadër.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Ndalimi i diskriminimit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çdo diskriminim ndaj cilido personi për shkak të përkatësisë së tij/saj në një pakicë kombëtare ndalohet. 2. Institucionet publike, qendrore dhe vendore miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme për të: <ol style="list-style-type: none"> a) garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës.; b) mbrojtur personat që i përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar, ose tradicional; c) forcuar dialogun ndërkulturor; d) nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar, ose tradicional. 3. Masat e miratuara në përputhje me paragrafin 2 nuk 	<p>Dispozita garanton mos diskriminimin e personave për shkak të përkatësisë në një pakicë kombëtare. Ajo është hartuar duke pasur parasysh dispozitat kushtetuese që garantojnë të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimin, aktet ndërkombëtare ku RSH është palë si dhe legjislacionin përkatës civil, penal apo administrativ. Është hartuar duke pasur parasysh dhe sugjerimet e konsulencës së KiE.</p>

përbëjnë akte diskriminimi.	
<p style="text-align: center;">Neni 8 Liria e organizimit dhe e drejta e përfaqësimit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Personat që i përkasin pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën e lirisë së grumbullimeve paqësore dhe lirisë së organizimit. 2. Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të krijojnë dhe të marrin pjesë në parti politike, shoqata, si dhe organizata të tjera civile në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, me qëllim shprehjen dhe mbrojtjen e interesave të tyre. 3. Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtën të zgjidhen në organet përfaqësuese në nivel qendror dhe vendor, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe legjislacionit përkatës në fuqi. 	<p>Dispozita reflekton dispozitat përkatëse kushtetuese në lidhje me të drejtat politike të njeriut, konventat ndërkombëtare, si dhe legjislacionin përkatës si psh ligjin për tubimet, për partitë politike apo legjislacionin civil. Dispozita bën një referim tek dispozitat e Kodit Zgjedhor duke qenë se është një akt më i lartë nga pikëpamja hierarkike dhe që rregullon posaçërisht procesin zgjedhor si nga pikëpamja procedurale ashtu dhe materiale. Për këtë qëllim nuk ka reflektuar sugjerimet nga disa përfaqësues të pakicave për të vendosur kuota për pakicat në organin legjislativ apo organet e pushtetit vendor.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Liria e fesë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të shfaqë, individualisht ose në komunitet me të tjerët, fenë ose besimin e tij/saj. 2. Personat që i përkasin një pakice kombëtare, kanë të drejtë të krijojnë institucionet, organizatat dhe shoqatat e tyre fetare në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. 	<p>Dispozita ka karakter të përgjithshëm dhe reflekton dispozitat përkatëse kushtetuese dhe Konventën Kuadër.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Pjesëmarrja në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Personave që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë për pjesëmarrje të barabartë dhe efektive në jetën publike, ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit, në veçanti në çështjet lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e kulturës, traditat dhe identitetin e pakicës në të cilën ata i përkasin. 2. Personat që u përkasin pakicave kombëtare dhe shoqatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare gëzojnë të drejtën e aplikimit dhe mbështetjen financiare nga institucionet e 	<p>Dispozita është hartuar duke pasur parasysh terminologjinë përkatëse të Konventës Kuadër dhe faktin se zbatimi i masave të parashikuara në të lidhet me angazhimin konkret të institucioneve shtetërore sipas fushave përkatëse që mbulojnë. Për këtë qëllim dispozita nevojitet të plotësohet me akte nënligjore.</p>

<p>kulturës, me qëllim promovimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e traditave të tyre, pa dallim identiteti kulturor, etnik, gjuhësor, ose tradicional , në përputhje me legjislacionin në fuqi për kulturën.</p> <p>3. Masat dhe politikat e nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrave përgjegjës për fushat e lartpërmendura</p>	
<p style="text-align: center;">Neni 11 Ruajtja e identitetit kulturor të pakicave kombëtare</p> <p>1. Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre gjuhësor, kulturor, fetar dhe trashëgiminë e tyre kulturore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>2. Në përputhje me dispozitat e nenit 2, personat që i përkasin pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën e krenimit të ngjarjeve që lidhen me promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor.</p> <p>3. Strategjitë, programet dhe planet e veprimit për të krijuar kushtet e nevojshme që pakicat kombëtare të ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre të dallueshëm miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrave përgjegjës për arsimin dhe kulturën.</p> <p>4. Pa cenuar masat e marra në përputhje me politikën e integritit të përgjithshëm të pakicave kombëtare, ndalohen politikat apo praktikat që synojnë asimilimin e personave që iu përkasin pakicave kombëtare kundër vullnetit të tyre.</p>	<p>Dispozita synon të realizon një ndër parimet bazë të Konventës Kuadër dhe të vetë interesave të pakicave: ruajtja e identitetit dhe mos asimilimi. Dispozita është hartuar duke pasur parasysh dhe sugjerimet e grupeve të interesit, ekspertizën e KiE dhe ligjet analoge të vendeve të tjera.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 E drejta e arsimit në gjuhën e pakicës</p> <p>1. Personat që i përkasin një pakice kombëtare gëzojnë të drejtën të mësojnë gjuhën e pakicës në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.</p> <p>2. Personave që u përkasin pakicave kombëtare, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ato banojnë tradicionalisht, u sigurohen mundësi për të mësuar ose për të marrë mësim në gjuhën e pakicës, në përputhje me</p>	<p>Dispozita garanton një ndër të drejtat bazë të pakicave duke pasur parasysh parashikimet e Konventës Kuadër dhe legjislacionin aktual në fushën e arsimit. E drejta e pakicave për arsim në gjuhën amtare është një e drejtë e qenësishme por pa cenuar mësimin e gjuhës shqipe. Dispozita ka karakter kuadër dhe</p>

<p>legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.</p> <p>3. Kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrave përgjegjës për arsimin dhe çështjet vendore.</p> <p>4. Masat e përshtatshme në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor me qëllim nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare dhe të shumicës në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.</p> <p>5. Masat e përshtatshme për krijimin e mundësive dhe kushteve për pajisjen me tekste shkollore, formimin fillestar, trajnimin dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin dhe funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për arsimin në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.</p> <p>6. Personat që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të hapin dhe drejtojnë institucione private të sistemit arsimor dhe institucione të arsimit profesional, kur plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara në legjislacionin në fuqi në fushën e arsimit.</p> <p>7. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen pa cenuar mësimin e gjuhës shqipe.</p>	<p>nevojitet të hartohen me VKM kriteret për garantimin e kësaj të drejte si në njësitë e pushtetit vendor ku ka një numër thelbësor po ashtu dhe në tërë territorin e RSH. Dispozita ka pasur parasysh dhe rekomandimet e ekspertizës së KiE.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13</p> <p style="text-align: center;">E drejta lirisë së shprehjes dhe informimit</p> <p>1. Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të shprehin opinione dhe të marrin e shpërndajnë informacione në gjuhën e pakicave pa diskriminim dhe pa ndërhyrjen e autoriteteve publike</p> <p>2. Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të kenë median e tyre të shkruar dhe elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë për median e shkruar dhe elektronike.</p>	<p>Dispozita është hartuar duke pasur parasysh parashikimet e Konventës Kuadër dhe legjislacionin përkatës në fushën e medias. Formulimi pa pasur parasysh dhe rekomandimet e konsulentës së KiE. Ky formulim nuk ka reflektuar disa sugjerime për përcaktimin e kuotave në organet medieve publike. Mbetet që organet e medieve publike të</p>

<p>3. Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të përdorin shërbimet e mediave audio dhe audiovizive, pa diskriminim në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Licencimi i shërbimeve të radiopërhapjes dhe televizionit bëhet pa diskriminim dhe në përputhje me kriteret e legjislacionit mbi mediat audiovizive.</p> <p>4. Personat që i përkasin pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën e informimit në gjuhën e tyre amtare. Radio dhe televizioni publik qendror transmeton në njërin prej stacioneve të tij, programe informative dhe kulturore në gjuhën e pakicave kombëtare.</p>	<p>detajojnë hapësirën në programacion apo përfaqësim pakicave.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Përdorimi i gjuhës</p> <p>1. Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të përdorin, krahas gjuhës shqipe, në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin:</p> <p>a) emrin dhe mbiemrin e tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës;</p> <p>b) shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale, të dukshme për publikun në çdo aktivitet të jetës së tyre sociale, ekonomike dhe kulturore.</p> <p>2. Në bashkitë ku personat që i përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht dhe përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj bashkie, bazuar në kërkesën e tyre, organet e vetëqeverisjes vendore krijojnë kushtet, për aq sa është e mundur, për përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave dhe këtyre organeve.</p> <p>3. Me vendim të këshillave bashkiakë, në bashkitë ku mbi 20% e banorëve u përkasin pakicave kombëtare, kur ka një kërkesë të mjaftueshme prej tyre, emërtimet e njësive administrative përkatëse, të rrugëve dhe të treguesve të tjerë topografikë, krahas gjuhës shqipe, shfaqen dhe në gjuhën e pakicës përkatëse, sipas parashikimeve ligjore për vetëqeverisjen vendore.</p>	<p>Ky nen përbën gjithashtu në ndër dispozitat të rëndësishme të projektligjit i konsultuar gjerësisht në grupin ndërministror, konsulencën e KiE e cila e ka vlerësuar si dispozitë. Formulimi ka dy elementë thelbësorë: përcaktimin e njësive së pushtetit vendor që referohet (bashkinë) duke reflektuar situatën aktuale në terren dhe përcaktimin e pragut 20% të popullsisë që i përket pakicës, prag i cili është përsëritur nga konsulenca e KiE. Pragu 20% aktualisht aplikohet më së shumti në eksperiencat analoge evropiane.</p> <p>Sidoqoftë dispozita ka nevojë për shtjellim të mëtejshëm me akte nënligjore për të garantuar zbatimin në praktike.</p>

<p>4. Në bashkitë ku personat që i përkasin pakicave kombëtare përbëjnë mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë të kësaj bashkie, kanë të drejtë të marrin informacion, krahas gjuhës shqipe, edhe në gjuhën e pakicës, mbi zhvillimin e procesit zgjedhor. Dhënia e informacioneve në gjuhën e pakicave mbi zhvillimin e procesin zgjedhor rregullohet me akte të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.</p> <p>5. Çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të informohet menjëherë, në gjuhën që ai/ajo kupton, mbi arsyet e arrestimit të tij/saj, dhe për natyrën dhe shkakun e çdo akuze kundër tij/saj, dhe për të mbrojtur veten e tij/saj në këtë gjuhë, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.</p> <p>6. Mënyra e përdorimit të gjuhës së pakicave sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij neni rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrive përgjegjëse për punët e brendshme dhe çështjet vendore.</p>	
<p style="text-align: center;">Neni 15 Ndalimi i kufizimit të së drejtave</p> <p>Ndalohet marrja e masave që ndryshojnë përbërjen e popullsisë në bashkitë e banuara nga personat që u përkasin pakicave kombëtare, me qëllim kufizimin e të drejtave të parashikuara nga ky ligj.</p>	<p>Dispozita synon ndalimin e masave abuzive nga autoritetet shtetërore që synojnë asimilimin e pakicave kombëtare. Vlerësuar nga ekspertiza e KiE dhe bazuar në Konventën Kuadër.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Marrëveshjet ndërkombëtare</p> <p>1. Personat që u përkasin pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën për të vendosur dhe mbajtur kontakte të lira dhe paqësore përtej kufijve të Republikës së Shqipërisë me personat me të cilët kanë të njëjtin identitet etnik, gjuhësor, fetar, ose një trashëgimi të përbashkët kulturore.</p> <p>2. Republika e Shqipërisë mund të lidhë marrëveshje ndërkombëtare me shtete të tjera për të siguruar mbrojtjen e personave që i përkasin pakicave kombëtare përkatëse në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet</p>	<p>Dispozita është hartuar bazuar në parashikimet e Konventës Kuadër.</p>

<p>Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>3. Marrëveshjet ndërkombëtare të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, përpara miratimit në parim nga Këshilli i Ministrave, konsultohen me Komitetin e Pakicave Kombëtare.</p>	
<p style="text-align: center;">Neni 17 Komiteti i Pakicave Kombëtare</p> <p>1. Me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të së drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi, ngarkohet Komiteti për Pakicat Kombëtare, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit.</p> <p>2. Organizimi, funksionimi dhe niveli i pagave të anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare dhe personelit administrativ përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>3. Struktura e Komitetit të Pakicave Kombëtare miratohet me urdhër të Kryeministrit.</p> <p>4. Rekrutimi dhe marrëdhëniet e punës të personelit administrativ rregullohen sipas parashikimeve të legjislacionit për nëpunësin civil dhe të Kodit të Punës.</p>	<p>Dispozita është hartuar në konsultim me Komitetin Shtetëror për Minoritetet bazuar në eksperiencën aktuale dhe mbështetur në eksperiencat e vendeve të tjera si Rep. Çeke apo Polonia. Komiteti do të jetë një strukturë konsultative në varësi direkte të Kryeministrit por me kompetenca më të zgjeruara se KSHM.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 18 Kompetencat e Komitetit</p> <p>Komiteti ka këto kompetenca:</p> <p>a) rekomandon dhe jep opinionin e tij në lidhje me hartimin e legjislacionit, politikave dhe programeve që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave kombëtare.</p> <p>b) propozon rekomandime për Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe organet e pushtetit vendor, për trajtimin e çështjeve që lidhen pakicat kombëtare.</p> <p>c) përgatit dhe dorëzon raporte periodike për Kuvendin mbi gjendjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë.</p>	<p>Dispozita është konsultuar gjerësisht me GP dhe KSHM duke reflektuar shqetësimin dhe kërkesën për të forcuar kompetencat e Komitetit i cili tashmë do të ketë kompetenca më të rëndësishme sa i përket hartimit të akteve ligjore, nënligjore e strategjive për pakicat kombëtare si dhe sa i përket mbështetjes financiare të projekteve në dobi të ruajtjes dhe zhvillimit të identitetit të pakicave. Dispozita është vlerësuar nga ekspertiza e KiE.</p>

<p>ç) bashkëpunon dhe koordinon me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor raportimin dhe monitorimin për zbatimin e kuadrit ligjor dhe politikave shtetërore në lidhje me pakicat kombëtare.</p> <p>d) organizon aktivitete me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicave kombëtare dhe forcimi i dialogut me shoqatat e pakicave kombëtare.</p> <p>dh) kontribuon në përgatitjen e raportit kombëtar për zbatimin e Konventës Kuadër “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”.</p> <p>e) ndërmerr aktivitete të cilat kanë si synim përmbushjen e angazhimeve dhe detyrimeve ndërkombëtare.</p> <p>ë) jep opinione në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat dhe liritë e i pakicave kombëtare.</p> <p>f) jep opinion pranë institucionit të parashikuar në nenin 3 pika 3 lidhur me kërkesat për njohjen e pakicave.</p> <p>g) financon nëpërmjet Fondit për Pakicat Kombëtare nismat dhe projektet që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar, gjuhësor dhe kulturor të pakicave kombëtare.</p>	
<p style="text-align: center;">Neni 19 Përbërja e Komitetit të Pakicave Kombëtare</p> <p>1. Komiteti i Pakicave Kombëtare përbëhet nga përfaqësuesit e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë të referuara në nenin 3, pika 2.</p> <p>2. Kryetari i Komitetit të Pakicave Kombëtare dhe Nënkyetari emërohen me urdhër të Kryeministrit mbi bazën e rotacionit të përfaqësuesve të pakicave çdo katër vjet. Pakica kombëtare e cila përfaqësohet në nivel Kryetari dhe Nënkyetari ka të drejtë të përfaqësohet dhe në nivel anëtar për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të Kryetarit dhe</p>	<p>Dispozita garanton trajtimin në mënyrë të balancuar të përfaqësimit të të gjithë pakicave të cilësuar në projektligj. Dispozita është hartuar bazuar dhe në kontributin e KSHM dhe sugjerimet e ekspertizës së KiE. Nevojitet detajimi i saj i kujdesshëm me akte nënligjore.</p> <p>Në shtojcën 1 jepet parashikimi për strukturën e Komitetit për</p>

<p>Nënkryetarit.</p> <ol style="list-style-type: none"> 3. Secila prej pakicave kombëtare të referuara në nenin 3 pika 2 të këtij ligji ka të drejtë të ketë nga një përfaqësues në cilësinë e anëtarit të Komitetit të Pakicave Kombëtare. Anëtarët e Komitetit të Pakicave Kombëtare emërohen me urdhër të Kryeministrit me propozim të Kryetarit të Komitetit të Pakicave Kombëtare, mbështetur në kandidaturat e paraqitura nga shoqatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare. Mandati i anëtarit të Komitetit është katër-vjeçar me të drejtë ripërtëritjeje. 4. Procesi i përzgjedhjes së Kryetarit, Nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Pakicave Kombëtare bëhet nëpërmjet një procesi të pavarur, transparent dhe gjithëpërfshirës. Procedurat dhe rregullat për zhvillimin e këtij procesi rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave të propozuar nga Kryeministri. 	<p>Pakicat Kombëtare e cila ka qenë kërkuar vazhdimisht nga KSHM pasi një strukturë e tillë mbështetëse ka munguar.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 20 Fondi për Pakicat Kombëtare</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Krijohet Fondi për Pakicat Kombëtare për mbështetjen e nismave dhe projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar të pakicave kombëtare. 2. Fondi financohet nga buxheti i shtetit dhe administrohet nga Komiteti për Pakicat Kombëtare. 3. Kriteret për mbështetjen e nismave dhe projekteve sipas 1 të këtij neni, kriteret e përzgjedhjes për financimin e tyre dhe administrimi i Fondit për Pakicat Kombëtare përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. 	<p>Dispozita reflekton një kërkesë të vazhdueshme të KSHM për krijimin e një fondi të posaçëm në mbështetje të pakicave të administruar nga Komiteti për Pakicat që ka munguar deri më sot. Krijimi i këtij fondi të posaçëm do të shërbejë paralelisht me fondet që do të akordohen për realizimin e programeve dhe strategjive sipas fushave përkatëse nga institucionet shtetërore. Për referim shtojca 2.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 21 Dispozita të fundit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Asgjë në këtë ligj nuk do të interpretohet si kufizim 	<p>Dispozita ka karakter të përgjithshëm duke pasur parasysh hierararkinë e normave sipas</p>

<p>apo shmangie prej të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të sanksionuara në legjislacionin në fuqi apo në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.</p> <p>2. Të drejtat e pakicave kombëtare që parashikohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë nuk ndryshojnë, shndërrohen apo shfuqizohen nga ky ligj.</p> <p>3. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, i krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 11.3.2004, ndryshuar me VKM nr. 822, datë 28.12.2005 i ushtron funksionet e tij deri në momentin e krijimit të Komitetit për Pakicat Kombëtare i parashikuar në nenin 17 të këtij Ligji.</p>	<p>nenit 116 të Kushtetutës.</p>
---	----------------------------------

Komente nga institucionet dhe aktorët e interesuar si rezultat i publikimit të projektligjin në portalin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme:

❖ KOMITETI SHTETËROR I MINORITETEVE

1. Në nenin 1 “Objekti” të shtohet shprehja “si individë dhe në komunitet” dhe të listohen të gjitha ligjet, konventat ndërkombëtare dhe udhëzimet e OKB, BE, Këshillit të Europës për gjuhën, liritë, mosdiskriminimin, të drejtën e pronësisë, të drejtën e vetëqeverisjes, vetëidentifikimit, etj.

Nuk është korrekte nga pikëpamja e teknikës legislative listimi i të gjitha akteve apo dokumenteve që i referohen të drejtave të pakicave pasi në të ardhmen mund të ndryshojnë ose mos ekzistojnë ndërkohe që dy dokumentet baze janë Kushtetuta dhe Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCNM).

2. Në nenin 2 “Qëllimi” të shtohet termi “të gjitha”, të sqarohet nocioni i termit “specifikë”, të shtohet termi “që garantojnë barazi praktike dhe efektive” dhe të shtohet pika 2 me përmbajtje: “Të drejtat dhe liritë e pjesëtarëve të pakicave kombëtare, si pjesë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duhet të jenë një komponent thelbësor i demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Republikën e Shqipërisë dhe duhet të trajtohen me prioritet në çdo aspekt, ligjvënje, udhëzim ose vendim të të gjitha strukturave vendimmarrëse në Republikën e Shqipërisë në nivel lokal, rajonal dhe qendror.”

Termi specifike i referohet të drejtave të veçanta të njeriut që janë thelbësore për identitetin e një personi që i përket pakicës kombëtare siç përcaktohet në FCNM dhe rekomanduar KiE. Formulimi i propozuar nga KMSH është parimor dhe ka një natyrë të përgjithshme që shtjellohet në të gjithë dispozitat e projektligjit. Gjithashtu, nuk respekton rregullat e teknikës legislative dhe nuk prodhon ndonjë efekt real në zbatim.

3. Në nenin 3 “Përkufizimi” të listohen pakicat e njohura aktualisht. Të shtohet një pikë ku të thotë: “Pakica të njohura kombëtare në Shqipëri janë Minoriteti Etnik Grek...”. Të parashikohet procedura e mirë përcaktuar si bëhet njohja e një pakice të re, (kush bën kërkesën, kujt i drejtohet, të parashikohet mundësia e shqyrtimit të aktit miratues ose refuzues të autoritetit përgjegjës nga organe gjyqësore).

Reflektuar.

4. Në nenin 6 “Mbledhja e të dhënave” të shtohet *“Deklarata e përkatësisë kombëtare të një shtetasi të Republikës së Shqipërisë bëhet me vetë-deklarim noterial në çdo kohë në adresën e Regjistrat Kombëtar të pakicave të Komitetit të Pakicave Kombëtare*
 2. *Asnjë bllokim, ndëshkim, gjobitje ose diskriminim nuk mund të rrjedhë nga vetë-deklarimi i përkatësisë kombëtare të shtetasve të Republikës së Shqipërisë.*
 3. *Regjistri kombëtar i pakicave është i ndërlidhur në mënyrë të njëanshme me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile vetëm për identifikimin e të dhënave bazë të shtetasit që vetë-identifikohet si pjesëtar i një pakice kombëtare*
 4. *Regjistri Kombëtar i Pakicave përdoret nga Komiteti i Pakicave Kombëtare për hartimin e politikave për pakicat kombëtare në nivel qendror ose vendor në bazë të dispozitave të këtij ligji*
 5. *Deklarata e përkatësisë së një personi në një pakicë kombëtare mund të bëhet për arsye statistikore shtetërore edhe në regjistrimet periodike të popullsisë që banon në Republikën e Shqipërisë bazuar në të drejtën e vetë-identifikimit personal.*
 6. *Në një regjistrim kombëtar të popullsisë, askush nuk mund të detyrohet të zbulojë të dhëna në lidhje me përkatësinë e tij/saj në një pakicë kombëtare dhe as përkatësinë e tij/saj etnike, gjuhësore ose fetare.*
 7. *Përpunimi i të dhënave të Regjistrat Kombëtar dhe të censusit realizohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.”*

Me vendim të Gjykatës Kushtetuese 2011 është hequr kombësia si element në regjistrat e gjendjes civile dhe paralelisht është e pamundur të krijohet një regjistër paralel. Edhe ekspertet e KiE nuk inkurajojnë identifikimin e kombësisë në dokumentet zyrtare sepse bie ndesh me parimin e vetë deklarimit Neni 3 zgjedhja ose jo e përkatësisë etnike Zgjedhja ose jo është libre dhe e ndryshueshme.

Sugjerimet e tjera reflektuar në nenin 5.

5. Në nenin 7 “ndalimi i diskriminimit”, termi “promovuar” të zëvendësohet me termin “garantuar”, të shtohet tek pika (a) “...nëpërmjet pjesëmarrjes analogjike në raport me numrin që zënë pjesëtarët e pakicave në numrin e përgjithshëm të popullsisë sipas rezultateve që rrjedhin nga procedurat e nenit 5 dhe 6”.

Sugjerimi parë reflektuar. Sugjerimi dytë nuk pranohet pasi bie ndesh me nenin 3 dhe 5 të FCNM (vetë deklarimi dhe gëzimi individual i të drejtave). Propozimi mund të krijonte diskriminim brenda pakicave.

6. Në nenin 8 “liria e organizimit” sugjerohet që Autoritetet garantojnë pjesëmarrjen e personave që ju përkasin pakicave në organet përfaqësuese në nivel qendror ose vendor edhe nëpërmjet mekanizmave të posaçëm (ulja e pragut elektoral, vende të rezervuara) sipas raporteve numerike që zënë pjesëtarët e pakicave në numrin e përgjithshëm të popullsisë sipas rezultateve që rrjedhin nga procedurat e nenit 5 dhe 6 në zbatim të parimit të diskriminimit pozitiv. Modalitetet përcaktohen në Kodin Zgjedhor.

Propozimi ka karakter shumë të përgjithshëm dhe nuk është konkret siç duhet të jetë nga pikëpamja e teknikës legjislativë. Formulimi i pikës 3 bën referimin tek Kodi Zgjedhor i cili së pari është një ligj që qëndron më lart në hierarkinë e normave së dyti është ai ligji i posaçëm që rregullon procesin zgjedhor. Projektligji i garanton të drejtën e përfaqësimit po nuk mund të parashikojë pragjet elektorale apo vendet e rezervuara të cilat parashikohen posaçërisht në Kodin Zgjedhor.

7. Në nenin 9 “liria e fesë” të shtohet “Çdo person ka të drejtë të ushtrojë ritet dhe traditat fetare në gjuhën amtare.”

E përfshin garantimi që i bën vetë neni.

8. Në nenin 10 “pjesëmarrja në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike” të shtohet termi “ju garantohet pjesëmarrja e barabartë dhe efektive” tek pika 1 dhe të shtohet tek pika 2 “ju garantohet mbështetja financiare nëpërmjet Krijimit të Fondit të Posaçëm Shtetëror për Pakicat Kombëtare që përdoret ekskluzivisht për financimin e projekteve të kësaj natyre.”

Pranuar pjesërisht sugjerimi duke iu përmbajtur termave të FCNM (Neni 15). Pika e 3 ketij neni shtjellon mënyrën e konkretizimit të pikës 1. Fondi është trajtuar në një nen të veçantë.

9. Në nenin 11 “Ruajtja e identitetit të pakicave kombëtare” të Shtohet tek pika 1: “Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë”. Të shtohet pas pikës 2 pika 3 me këtë përmbajtje: “Këshilli i Ministrave miraton me propozim të Komitetit për Pakicat Kombëtare masat dhe politikat e nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike, duke siguruar mekanizmat dhe mbështetjen financiare të garantuar nga Fondi për Pakicat Kombëtare, nga pushteti vendor ose nga buxheti i institucioneve shtetërore.”

Sugjerimi 1 pranohet dhe reflektohet dhe është në përputhje me HCMN. Sa i përket sugjerimit 2, kompetencat e komitetit dhe Fondi trajtohen në nene të veçanta.

10. Neni 12 “E drejta e arsimit në gjuhën e pakicës” të ketë këtë përmbajtje

- “1. Shteti u siguron personave që u përkasin pakicave kombëtare arsimimin në gjuhën amtare në arsimin parashkollor, arsimin bazë, arsimin e mesëm të lartë dhe arsimin e lartë të sistemit publik në Republikën e Shqipërisë*
- 2. Arsimimi në gjuhën amtare në nivelet arsimore të sipërcituara realizohet në sistemin aktual të shkollave në gjuhën amtare, si edhe nëpërmjet hapjes së njësive të reja arsimore, sipas nevojave të anëtarëve dhe komuniteteve të pakicave kombëtare.*
 - 3. Shkollat në gjuhën amtare të pakicave kombëtare funksionojnë në mënyrë të pavarur, përveç rasteve kur vet komunitetit vendos ndryshe.*
 - 4. Iniciativa për hapjen e një institucioni të ri arsimor në arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin të mesëm të lartë në gjuhën amtare në sistemin arsimor publik, i takon komunitetit përkatës të pakicave kombëtare. Iniciativa e tyre legjitimohet kur ekzistojnë kushte të mjaftueshme tradicionale e të aktualitetit, kur ekziston një numër minimal nxënësish që lejon zhvillimin normal të mësimin dhe plotëson kriteret kushtetuese e të akteve ndërkombëtare në fushën e arsimimit në gjuhën amtare.*
 - 5. Hapja, mbyllja apo bashkimi i institucioneve arsimore të pakicave kombëtare bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Arsimit.*
 - 6. Mbarëvajtja e infrastrukturës së institucioneve shkollore në gjuhën amtare të pakicave kombëtare bëhet sipas parashikimeve të dispozitave të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore për implementimin e tij.*
 - 7. Në planet dhe programet e shkollave në gjuhën amtare të arsimit bazë e të mesëm të lartë, lëndët në gjuhën amtare kanë për qëllim mësimin e gjuhës amtare, të historisë dhe kulturës së pakicës kombëtare si komunitet e të kombit amë. Në gjuhën amtare zhvillohen edhe lëndët shoqërore që formojnë e kultivojnë tek nxënësit e pakicave kombëtare karakteristikat e identitetit të tyre etnik, shoqëror e kulturor.*
 - 8. Për të mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, nxënësve të pakicave kombëtare u krijohen kushte për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e historisë e të kulturës shqiptare.*
 - 9. Raportet konkrete midis lëndëve në gjuhën amtare dhe lëndëve në gjuhën zyrtare përcaktohen me vendim të Ministrit të Arsimit, në të cilën respektohet mendimi i palëve të interesuara. Numri i lëndëve në gjuhën zyrtare nuk prevalon atë të lëndëve në gjuhën amtare.*
 - 10. Librat në gjuhën amtare për shkollat e pakicave kombëtare sigurohen nëpërmjet:
 - a. krijimit të teksteve origjinale për lëndë të gjuhës amtare, historisë, gjeografisë e kulturës kombëtare;**

- b. përkthimit në gjuhën amtare nga gjuha zyrtare të teksteve të lëndëve shoqërore dhe përshtatjes së tyre natyrës së nxënësve të pakicave kombëtare,*
- c. si edhe përkthimit nga gjuha zyrtare të teksteve me karakter të mirëfilltë shkencor.*

- 11. Kjo procedurë është e vlefshme edhe për tekstet të lëndëve në gjuhën amtare për shkolla e mesme të larta në gjuhën amtare*
- 12. Tekstet shkollore në gjuhën amtare për shkollat e pakicave kombëtare përgatiten nga subjekte apo institucione të specializuara dhe të kualifikuara, pas aprovimit nga Ministria e Arsimit.*
- 13. Programet e teksteve për lëndët në gjuhën amtare hartohen dhe aprovohen nga strukturat përkatëse në Ministrinë e Arsimit me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në hartim dhe vendimmarrje të specialisteve të fushës nga pakicat respektive kombëtare.*
- 14. Për përgatitjen cilësore të teksteve dhe programeve mësimore për shkollat në gjuhën amtare është e mirëpritur asistenca e specialisteve nga kombi amë i pakicave kombëtare, ose i specialisteve të huaj me njohuri të plota në këtë drejtim.*
- 15. Nëse programet dhe tekstet në gjuhën amtare kanë përputhje me ato analoge në kombin amë të pakicave kombëtare, është i mirëpritur bashkëpunimi për sigurimin e tyre. Në çdo rast vendimi merret nga Ministria e Arsimit*
- 16. Për mbarëvajtjen e arsimit në gjuhën amtare të pakicave kombëtare Ministria e Arsimit dhe Sportit ngre struktura në nivel inspektorësh me specialist të arsimit nga pakicat kombëtare. Ato funksionojnë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe pranë drejtorive rajonale, dhe janë në varësi të drejtpërdrejt nga Ministria e Arsimit. Detyra e tyre është mbikëqyrja e procesit arsimor në shkollat në gjuhën amtare të pakicave kombëtare, asistenca administrative, pedagogjike e juridike dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me Ministrinë për zgjidhjen e problemeve të mundshme.*
- 17. Ministria e Arsimit dhe Sportit siguron infrastrukturën e përshtatshme në arsimin e lartë për përgatitjen e kuadrit arsimor sipas të gjitha specialiteteve, niveleve dhe kërkesave të kohës. Këto institucione, në bashkëpunim me strukturat përkatëse në Ministrinë e Arsimit dhe drejtoritë rajonale të arsimit, ngarkohet edhe me detyrën e kualifikimit të vazhdueshëm të arsimtarëve për lëndët në gjuhën amtare .*
- 18. Në portalin e punësimit të arsimtarëve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit hapet dhe funksionon zëri specifik për punësimin e arsimtarëve për shkollat në gjuhën amtare të pakicave kombëtare.*
- 19. Arsimtarët për lëndët në gjuhën amtare në shkollat e pakicave kombëtare i përkasin të njëjtit komunitet.*
- 20. Personat që i përkasin pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën e arsimimit në gjuhën amtare edhe pranë institucioneve të arsimit privat të të gjitha niveleve që janë ngritur*

dhe funksionojnë apo do të ngrihen në të ardhmen, në përputhje me aktet përkatëse të Këshillit të Ministrave dhe sipas kurrikulave të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.”

Përgjigje: Nga pikëpamja e teknikes legislative ndryshimet e sugjeruara janë shume teknike dhe do te merren ne konsiderate ne hartimin e akteve nënligjore përkatëse.

11. Në nenin 13 “liria e shprehjes” të shtohet përmbajtja e mëposhtme:

“1. Personat që i përkasin pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën e informimit në gjuhën e tyre amtare. Radio dhe televizioni publik qendror transmeton në njërin prej stacioneve të tij, programe informative (lajmet) dhe programe kulturore në gjuhën e pakicave kombëtare. Zgjatja në kohë dhe përmbajtja e programit përcaktohet nga përfaqësuesit e pakicës kombëtare dhe aprovohet nga drejtuesit e RTV-së publike.

2. Radio-televizionet publike lokale u lënë hapësirë në programin e vet, programeve në gjuhën amtare të pakicës kombëtare, në raport me peshën që ky komunitet zë përbërjen e popullsisë rajonale të shumicës.

Programi hartohet nga vet komunitetit dhe aprovohet nga strukturat përkatëse të radiotelevizionit publik qendror. Shteti merr masa financiare, infrastrukurore dhe njerëzore për realizimin e programit të hartuar.

3. Shteti shqiptar inkurajon çeljen e stacioneve radio-vizuale, apo dhe të publikimit të revistave dhe gazetave në gjuhën e pakicave në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Shteti shqiptar garanton pjesëmarrjen e përfaqësuesve të minoriteteve në entet drejtuese të institucioneve rregullatore mediatike dhe bordeve drejtuese të institucioneve mediatike shtetërore.”

Në thelb ky propozim përfshihet në nen. Përshtatur sipas sugjerimeve.

12. Neni 14 “Përdorimi i gjuhës” të këtë përmbajtjen e mëposhtme:

“Përdorimi i gjuhës amtare dhe emërtimeve

1. Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të përzgjedhin të regjistrohen ose të ndryshojnë në Regjistrat Civilë të Republikës së Shqipërisë, lirshëm dhe pa asnjë kufizim, emrin dhe mbiemrin e tyre në standardet ndërkombëtare të gjuhës amtare me përdorim të alfabetit latin.

2. Personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të përdorin, krahas gjuhës shqipe, në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale, të dukshme për publikun në çdo aktivitet të jetës së tyre sociale dhe ekonomike pas asnjë kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Barazia në përdorimin zyrtar të gjuhës së pakicave, krahas gjuhës shqipe, do të ushtrohet detyrimisht në territorin e një njësie të vetëqeverisjes vendore, ku pjesëtarët e

pakicës kombëtare përbëjnë të paktën një të tretën e popullsisë sipas censusit ose Regjistrin Kombëtar të Pakicave.

4. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në nivel vendbanimi, bashkie ose qarku, ku personat që i përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht ose/dhe janë të regjistruar nga censusi kombëtar ose nga Regjistri i Pakicave Kombëtare me vetë-identifikim në numër thelbësor më shumë se 15% të popullsisë, ose/dhe ka një kërkesë me petition të firmosur nga minimumi 7% i banorëve nëpërmjet strukturave vetë-administruese të pakicave kombëtare.

Organet e vetëqeverisjes/njësitë administrative vendore krijojnë kushtet, sipas parashikimeve ligjore për vetëqeverisjen vendore, për përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave dhe këtyre organeve.

Përkthimin e menjëhershëm të të gjitha vendimeve të njësisë administrative edhe në gjuhën e pakicave kombëtare emërtimet e njësisë administrative përkatëse, rrugëve dhe treguesve të tjerë topografikë, krahas gjuhës shqipe, shfaqen dhe në gjuhën e pakicës përkatëse marrjen e informacionit, krahas gjuhës shqipe, edhe në gjuhën e pakicës, mbi zhvillimin e proceseve zgjedhore marrjen e çdo informacioni të rëndësishëm, fushate sensibilizuese, konsultimi publik, legjislacioni, nga qeverisja rajonale dhe vendore, krahas gjuhës shqipe edhe në gjuhën e pakicës.

5. Çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtën të kërkoj informacion në gjuhën e pakicës nga të gjitha strukturat dhe institucionet publike.

6. Financimi i përdorimit të gjuhës amtare në të gjitha nivelet kryhet nga Fondi Kombëtar për Pakicat.”

Pika e 1 nuk gjendet e referuar në FCNM dhe as në legjislacionet e vendeve që janë konsultuar.

Pika 2 reflektuar pjesërisht sugjerimi i KSHM. Frazja “në gjithë territorin” nuk ka nevojë të shtohet sepse parashikohet në nenin 4 pika 2. Reflektuar pjesërisht sugjerimi i për 1/3 të popullsisë. Termi tradicionalisht është termi i konventës dhe 1/3 është kriter sqarues në përcaktimin e kësaj të drejte.

Pika 3: Formulimi është shumë i përgjithshëm jo në përputhje me parashikimet e konventës neni 10. Reflektuar pragu 20% e popullsisë së njësisë administrative (bashkisë).

Pika 4: Është i paqartë si formulim dhe nuk kuptohet se çfarë kërkohet të sanksionohet.

Formulimi është shumë i përgjithshëm dhe është trajtuar në të gjithë nenin 14.

Pika 5: Ky formulim del përtej parashikimeve të konventës. Gjithsesi realizimi i kësaj të drejte realizohet në varësi të mundësive që kanë autoritetet administrative vendore.

Pika 6:Për këtë formulim duhet të shprehet më qartë KSHM dhe Ministria e Financave.

13. Të shtohet neni 15 dhe 16 me këtë përmbajtje:

“Neni 15: E drejta për kremtimin të evenimenteve historike e kulturore.

Pjesëtarët e pakicave kombëtare gëzojnë të drejtën dhe lirinë e përkujtimit, festimit e promovimit në të gjitha format e mundshme për ta, të ngjarjeve që i përkasin traditës së vet historike, kulturore e fetare, që kanë lidhje me pakicën kombëtare, apo me kombin amë, të figurave të shquara për historinë dhe kulturën e pakicës kombëtare apo të kombit amë.

Këto veprimtari duhet të respektojnë dispozitat e nenit 2 të këtij ligji.

Parashikohet në nenin 11.

14. Neni 16: Përdorimi i simboleve kombëtare.

Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë të përdorin simbolet dalluese të tyre dhe simbolet e përkatësisë kombëtare.

Pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë që në çdo organizim vullnetar, shoqëror, politik, kulturor apo dhe ekonomik të përdorin logo, simbole apo disign-e nga tradita historike dhe kulturore e pakicës dhe të kombit amë.

Këtë të drejtë e kanë në përdorimin e logos apo dhe të simboleve të tjera edhe strukturat e pushtetit vendor. Në këtë rast çdo mbishkrim në gjuhën amtare shoqërohet edhe me gjuhën zyrtare.

Në zonat me popullsi kompakte të pakicës kombëtare, lejohet edhe në institucionet publike përdorimi i ngahershëm i simboleve kombëtare të pakicës, siç është flamuri, krahas atyre të Republikës së Shqipërisë.

Në raste të tjera përdorimi paralel i simboleve kombëtare nga ana e pjesëtarëve të pakicës kombëtare, lejohet në ditë kremtimi, përkujtimi apo promovimi të festave kombëtare, ngjarjeve historike, kulturore etj.”

Aktualisht nuk ka një ligj në Shqipëri që rregullon përdorimin e flamujve dhe simboleve kombëtare i cili të parashikojë dhe përdorimin e simboleve të pakicave.

Konventa nuk parashikon elementin e përdorimit të simboleve kombëtare. Gjithsesi ky propozim mund të gjeje reflektim në një ligj të posaçëm për përdorimin e simboleve kombëtare.

15. Në nenin 15 “ndalimi i kufizimit të të drejtave” të shtohet paragrafi “Çdo akt ose veprim privat ose shtetëror që cenon të drejtën e pronës private ose komunitare të pjesëtarëve të pakicave kombëtare duhet të trajtohet dhe miratohet me dispozita të veçanta ligjore dhe administrative për të garantuar mos-shpërnguljen e pjesëtarëve të pakicave kombëtare nga trojet e tyre, mos-cenimin e aktivitetit ekonomik dhe ekuilibrave socialë në zona tradicionalisht të banuara nga pjesëtarë të pakicave kombëtare.”

Është mbajtur neni sipas përcaktimit që bën neni 16 i FCNM. Sa i përket sugjerimeve për Kreun III “Komiteti i Pakicave Kombëtare” janë reflektuar sugjerimet e KSHM veçanërisht për sa i përket forcimit të kompetencave të Komitetit për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe mbështetjes financiare të aktivitetit të tij.

❖ KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Sugjerimi për nenin 3 “Përkufizimi” është reflektuar në projektligj, ndërsa dy komentet e tjerë nuk janë pranuar pasi terminologjia e përdorur në projektligj është në përputhje me atë të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (Konventa Kuadër).

Sugjerimet për nenin 4 “Ushtrimi i të drejtave” dhe nenin 5 “E drejta e vetë identifikimit” janë reflektuar në projektligj.

Sugjerimet për nenin 7 “Ndalimi i diskriminimit” nuk janë pranuar pasi nuk janë në përputhje me terminologjinë që përdor Konventa Kuadër.

Neni 8 “Liria e organizimit” është hartuar në përputhje me sugjerimet e ekspertit ligjor të kontraktuar nga Këshilli i Evropës dhe Komisionerit të lartë për Pakicat Kombëtare të OSBE-së. Sa i përket komentit që ligji të ketë referencë numrin dhe datën, sqarojmë se nga pikëpamja e teknikës legjislative, nuk mund të pranohet pasi ligjet e referuara mund të ndryshojnë në të ardhmen.

Sugjerimet për nenin 9 “Liria e fesë” janë pranuar pjesërisht, pasi neni është në përputhje me terminologjinë e Konventës Kuadër.

Sugjerimet për nenin 10 “Pjesëmarrja në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike” dhe nenin 11 “Ruajtja e identitetit kulturor të pakicave kombëtare” janë reflektuar në projektligj.

Në lidhje me sugjerimet për nenin 12 “E drejta e arsimit në gjuhën e pakicës”, sqarojmë se ky nen është riformuluar në përputhje me sugjerimet e ekspertizës ndërkombëtare, ministrive të linjës dhe Komitetit Shtetëror të Minoriteteve. Komentin e parë për pikën 3 të këtij neni do ta reflektojmë para se projektligji të miratohet.

Neni 13 “E drejta lirisë së shprehjes dhe informimit” është riformuluar në përputhje me sugjerimet e ekspertizës së Këshillit të Europës dhe Autoritetit të Medias Audiovizive.

Sugjerimet për nenin 14 “Përdorimi i gjuhës” janë pranuar, ndërkohë sugjerimi për pikën 3 të këtij neni e gjykojmë të rëndësishëm.

Sugjerimet për nenin 15 “Ndalimi i kufizimit të së drejtave”, nenin 16 “Marrëveshjet ndërkombëtare” dhe nenin 17 “Komiteti i Pakicave Kombëtare” janë reflektuar në projektligj.

❖ QENDRA RES PUBLICA

1. Për sa i takon përcaktimit dhe përkufizimit të pakicave.

Ekzistenca e minoritetit është një çështje fakti dhe përkufizimi duhet të përfshijë faktorët objektivë dhe subjektivë të mësipërm (pra tipare të përbashkëta etnike, gjuhësore ose fetare dhe dëshira e këtij grupi për t’u identifikuar si të tillë). Çdo person që i përket një pakice kombëtare ka lirinë që të zgjedhë për t’u trajtuar apo jo si i tillë. Kjo dispozitë ia lë këtë zgjedhje çdo personi të tillë për të vendosur nëse dëshiron apo jo që të vendoset nën mbrojtjen që sigurojnë parimet e Konventës kuadër. Zgjedhja nuk nënkupton thjesht një të

drejtë për një individ që të zgjedhë arbitrarisht që t'i përkasë një pakice kombëtare. Zgjedhja subjektive individuale është pandashmërisht e lidhur me kriterin objektiv përkatës të identitetit të personit (Konventa).

Në ligj nuk përcaktohet se cili do të jetë kriteri objektiv ose kush do të certifikojë në fund të dhënat e dala nga regjistrimi i popullsisë. Kjo kompetencë mund t'i lihet Komitetit të Minoriteteve.

Ky shqetësim gjen reflektim në nenin 3(3) të projektligjit.

2. Në përputhje me Kushtetutën projekt-ligji i adresohet pakicave kombëtare duke hequr dallimin ekzistues me pakicat etno -gjuhësore. Projektligji njih si pakica kombëtare: grekët, maqedonasit, vllehët, romët, serbët, malazezët, egjiptianet dhe boshnjakët.

Projektligji ka për qëllim shmangien e dallimeve ndërmjet pakicave kombëtare dhe duke i listuar të gjitha në nenin 3(2) të tij.

3. Në nenin 1 të projekt ligjit sugjerojmë që termi *të drejta specifike të njeriut* të zëvendësohet me termin *të drejta shtesë*, pasi të Drejtat e Njeriut janë të pandashme dhe ato gëzohen njëherazi edhe nga anëtarët e komuniteteve. Nga pikëpamja gjuhësore juridike nuk ekziston termi “të drejta specifike të njeriut”. Në këtë kontekst, Komenti i Përgjithshëm Nr. 23 i Komitetit të Përgjithshëm së të Drejtave të Njeriut saktëson se neni 27 i Konventës Kuadër nuk përcakton të drejta kolektive ose të drejtat e një kolektivi por krijon dhe njih të drejtën që iu është dhënë individëve që i përkasin grupeve minoritare dhe që është “*e dallueshme nga*” dhe “*shtesë*” mbi të gjitha të drejtat e tjera të cilat ata gëzojnë si individ të një shoqërie. E drejta që grantohet nga neni 27 i kësaj Konvente është autonome brenda Konventës.

Është hequr termi “specifike” nga neni 1 i projektligjit.

4. Në nenin 7 sugjerojmë që të autorizohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore ku të mund të parashikohen të gjitha të drejtat që do të përbënin në fakt diskriminim pozitiv me qëllim arritjen në mënyrë efektive të barazisë thelbësore para ligjit.

Garantimi i të drejtave sanksionohet nga akte ligjore dhe nënligjore. Për më tepër që këto të drejta pakicat kombëtare i gëzojnë si të gjithë qytetarët shqiptarë.

5. Në nenin 8, vihet re e njëjta frymë si gjatë gjithë ligjit, ku sanksionohen të drejta që anëtarë të komuniteteve minoritare i gëzojnë si anëtarë të shoqërisë, që do të thotë mungojnë masa pozitive, të drejta shtesë të tyre, që është në fakt edhe qëllimi i ligjit. Duke iu kthyer nenit 8 mendojmë në paragrafin 3 të jepet mundësia e përfaqësimit në organet përfaqësuese të këtyre komuniteteve në një përqindje të caktuar. Kjo do të qe më e domosdoshme në rastin e organeve të qeverisjes vendore ku janë të përqendruara pakicat.

Projektligji garanton të drejtën e pakicave për tu përfaqësuar në organet përfaqësuese të qeverisjes vendore pavarësisht se nuk përcakton përqindje në këtë përfaqësim. Situata aktuale dëshmon se në bashkitë ku ka një përqindje të konsiderueshme të pakicave këto të fundit janë të përfaqësuara në këshillat bashkiakë.

6. Në nenin 13, Liria e shprehjes, mendojmë se nevojitet të sanksionohet detyrimi i Radio Televizionit Shqiptar, të verë në dispozicion të pakicave një kohë të caktuar transmetimi të dedikuar pakicave, si për nga zgjedhja e gjuhës në të cilin transmetohet edhe nga ana e përmbajtjes. Një detyrim i tillë mund të detajohet në këtë ligj ose të autorizohet Kuvendi të rregullojë këtë çështje me anë të një vendimi të vecantë, sepse RTSH është organ i pavarur. Një mundësi e mirë është që këto parashikime të përfshihen në statutin e ri të RTSH që është në proces miratimi. Kjo sërish do të ndihmonte në realizimin e ligjit që është realizimi i disa të drejtave shtesë që u takojnë anëtarëve të pakicave.

Neni 13(3) garanton që personat që i përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të përdorin shërbimet e mediave audio dhe audiovizive, pa diskriminim në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Licencimi i shërbimeve të radiopërhapjes dhe televizionit bëhet pa diskriminim dhe në përputhje me kriteret e legjislacionit mbi mediat audiovizive.

7. Në nenin 17, nuk është e qartë si zgjidhet Bashkëkryesuesi dhe anëtarët që përfaqësojnë pakicat. Nëse nuk vendosen kriteret ligjore do të jetë tërësisht në diskrecionin e Kryeministrit zgjedhja e tij/saj. Mendojmë se, për të shmangur arbitraritetin në vendimmarrje, këtu duhet të vendosen disa kriteret. Për shembull, Kryetari ose shumica e anëtarëve të jetë përfaqësues të komunitetit rom ose egjiptian, si dy pakicat më të diskriminuara në vend (raportuar nga raporte kombëtare dhe ndërkombëtare). Në mënyrë alternative do ishte e preferueshme që Kryetari dhe anëtarët e këtij Komiteti të zgjidheshin nga Kuvendi. Kjo do të garantonte më shumë pavarësi në punën dhe vendimmarrjen e këtij organi, me qëllim garantimin e të drejtave të minoriteteve.

Shqetësimi gjen reflektim në nenin 19. Dispozita është riformuluar

8. Në zbatim të kërkesës së paragrafit të tretë të nenit 11 të Konventës Kuadër më 27.07.2006 është nënshkruar një memorandum midis organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, në një paragraf të posaçëm të së cilit përcaktohet edhe detyrimi për vendosjen e emërtimeve tradicionale vendore, treguesve topografikë edhe në gjuhën e minoritetit. Për t'i dhënë fuqi ligjore këtij angazhimi, Këshilli i Ministrave me aneksin 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 446, datë 05.03.2008 "Për përcaktimin e specifikimeve teknike të tabelave të emërtimeve të parqeve, shesheve, bulevardëve e rrugëve dhe të numërimit të ndërtesave", në kapitullin II "Forma dhe përmasat", pika c) shprehet si më poshtë vijon: "Në njësinë e qeverisjes vendore ku banojnë minoritete kombëtare dhe kur ka kërkesë, tabelat do të shkruhen në dy gjuhë, duke iu përmbajtur specifikimeve teknike të tabelave dhe duke ruajtur të njëjtën madhësi shkronje për të dyja gjuhët". Për arsyet më sipër mendoj se pragu prej 20% i vendosur në ligj, për të mundësuar përdorimin e gjuhës në tabela, simbole, etj, duhet të rishikohet për të qenë në koherencë me legjislacionin ekzistues.

Pragu 20% është në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Europës.

❖ SHOQATA EGJIPTIANËT E BASHKUAR TË SHQIPËRISË

1. Në nenin 2 (1) termi “shoqëri e integruar” është i papërshtatshëm pasi që bie në kundërshtim me qëllimin e vetë ligjit. Të përdoret termi shoqëri gjithëpërfshirëse.

Sugjeruar nga Komiteti Shtetëror për Minoritetet

2. Në nenin 3 përkufizimi duhet ti japë përparësi parimit të vetëidentifikimit dhe jo faktorëve jashtë individit. Ky përkufizim i kushton rëndësi vetëm faktorëve të jashtëm dhe jo vetëidentifikimit, si një nga parimet kryesore të konventës kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare.

Formulimi i dispozitës i jep përparësi elementit të vetëdeklarimit. Elementët e tjerë që plotësojnë kuadrin e identifikimit të përkatësisë së individit në një pakicë kombëtare bazohen në praktikën e vendeve europiane dhe synojnë të garantojnë një proces identifikimi real, transparent dhe ligjor.

3. Në nenin 17 të përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së bashkëkryetarit. Të përcaktohet qartë në ligj kriteret e përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Komitetit.

Është hequr varianti i bashkëkryetarit dhe është hartuar një Kre, III, i dedikuar Komitetit.

❖ LËVIZJA RINORE EGJIPTIANE DHE ROME

1. Në nenin 1, termi “shoqëri e integruar” bie në kundërshtim me vet qëllimin e këtij ligji që është mbrojtja (identitetit, kulturës, traditës, zakoneve të pakicave kombëtare), të përdoret një term tjetër “Shoqëri gjithëpërfshirëse ose multikulturale”.

Formulimi është sugjeruar nga Komiteti Shtetëror për Minoritetet

2. Në nenin 3, parimi kryesor i përkufizimit pakicë kombëtare sipas këtij neni është kriteri objektiv dhe jo ai subjektiv në kundërshtim me frymën e konventës kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Mosrespektimi i parimit të vetëidentifikimit sjell pasoja direkt për mosnjohjen e komunitetit egjiptian, boshnjak dhe vllah si pakicë kombëtare. Tagrin për ta vendosur se do apo jo të shprehet se i përket një pakice kombëtare duhet ta ketë individi dhe jo dikush jashtë individit. Përsa i përket termit të përdorur “dalluese kulturore” të jete për “shkak të dallimeve kulturore etj”. Ligji duhet të shoqërohet me një listë të njohjes së minoriteteve ekzistuese dhe të tjera të panjohura deri tani de Juro.

Projektligji i ka reflektuar të gjitha pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë në kuptimin e vetë ligjit, në nenin 3(2) të tij.

3. Në nenin 5, në rast se nuk pranohet të ketë një listë të pakicave të kombëtare që do të jenë subjekt i këtij ligji atëherë të jepen garanci ligjore për realizimin e një censusi i cili në

mënyrë reale të pasqyroj praninë e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Ky census t'i japi prioritet parimit të vetëidentifikimit.

Projektligji i ka reflektuar listën e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë në nenin 3(2) të tij.

4. Në nenin 7, çfarë do të thotë masë e nevojshme ? Ligji duhet të vendosë afate institucioneve për nxjerrjen e këtyre masave si dhe mekanizmat se si do të mbrohen?

terminologjia “masë e nevojshme” është në përputhje me terminologjinë e FCNM, nenin 5 të saj.

5. Në nenin 17 të përcaktohet numri, formula e përzgjedhjes së anëtarëve. Gjithashtu të bëhen më të qarta kriteret dhe formula që do përzgjedhë Bashkëkryetarin. Sugjerojmë të zbatohet formula e rotacionit për Bashkëkryetarin, ose në rast të kundërt të përcaktohen afate për kohëzgjatjen e përfaqësimit si dhe jo më shumë se një herë e drejta përfaqësimit.

Sugjerimet gjejnë reflektim në Kreun III dedikuar Komitetit në projektligj. Bashkëkryetar është hequr si variant.

❖ BASHKIMI DEMOKRATIK I MINORITETIT ETNIK GREK “OMONIA”

OMONIA, sugjeron një projektligj të ri për arsyet si vijojnë:

A) Shumë nene janë të paqarta: Draftet e mëparshme, të cilat u konsultuan në takime në Ministrinë e Jashtme, në të cilat morëm pjesë, kishin mangësi, por qenë më konkrete. Konsiderojmë se tërësia e amendimeve të bëra kanë për qëllim paqartësinë.

B) Varësia e zbatimit të ligjit nga predispozitat e Këshillit të Ministrave. Politikat për pjesëmarrjen në jetën publike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të vendit (neni 10) si edhe mbrojtja e identitetit etnik (neni 11) vihen në varësi të politikave të Këshillit të Ministrave dhe nuk do të përbëjnë të drejta të konsoliduara.

C) Arsimi dhe përdorimi i gjuhës, që përbëjnë nenet më të rëndësishme të këtij ligji, nuk rezultojnë si të drejta të padiskutueshme, sikundër edhe duhet, por si nevojë e gjykuar nga Këshilli i Ministrave (par 4 neni 12 dhe par 6 neni 14).

D) Mungesa e neneve thelbësore, si diskriminimi pozitiv, pjesëmarrja në sistemin gjyqësor, mbrojtja e pronës etj.

Projektligji ka natyrë është hartuar duke pasur parasysh standardet që vendos FCNM, ekspertizën e Këshillit të Europës si dhe harmonizuar kërkesat e grupeve të ndryshme që përfaqësojnë interesat e pakicave kombëtare. Pas miratimit të projektligjit do të hartohen aktet nënligjore që do të mundësojnë zbatim të tij.

❖ ORGANIZATA “SFINKSI” E MINORITETIT TË EGJIPTIANËVE TË SHQIPËRISË PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM

1. Në nenin 2 termi “shoqëri e integruar” është i papërshtatshëm pasi bie në kundërshtim me qëllimin e vetë ligjit.
Në qëllimin e këtij projektligji të përfshihet gjithashtu:
 - Përcaktimi i statusit të pakicave kombëtare;
 - Përcaktimi i mënyrave me të cilat do të bëhet njohja e identitetit të tyre;
 - Përshkrimi i masave efektive që do të mundësonin njohjen mbi kulturën dalluese të secilës prej këtyre pakicave, nga pjesa e tjetër e shoqërisë.

Formulimi i variantit final të projektligjit dhe kuadri i akteve nënligjore që do të miratohen në zbatim të tij do reflektojnë sugjerimet/komentet e lartpërmendura.

2. Në nenin 3, të bëhet dallimi midis “pakicave kombëtare” dhe “minoriteteve kombëtare”. Si dhe përcaktimi i grupeve të përfshira nën termin “pakicë kombëtare”. Si përfundim përkufizimi duhet ti japë përparësi parimit të vetëidentifikimit dhe jo faktorëve jashtë individit. Ky përkufizim i kushton rëndësi vetëm faktorëve të jashtëm dhe jo vetëidentifikimit si një nga parimet kryesore të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e pakicave Kombëtare.

Termi “pakicë kombëtare” është referuar në përputhje me Kushtetutën, FCNM, rekomandimet e KiE për shmangien e dallimeve ndërmjet pakicave. Gjithashtu janë reflektuar të gjitha pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë në kuptimin e ligjit, në nenin 3(2) të tij. Reflektuar sugjerimi për heqjen e lidhëzës “dhe” në nenin 4(1).

3. Shprehen dakord për nenin 7, por e shohin jo eficient në praktikë ndaj sugjerojnë marrjen e sanksioneve të ndryshme administrative dhe civile në rast shkeljeje të kësaj dispozite.

I është qëndruar terminologjisë dispozitës që përdor FCNM në nenin 5. Pranuar sugjerimi për riformulimin e nenit 13(1).

4. Në nenin 17 të shtohen dispozita që tregojnë qartë krijimin, organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Komitetit. Të përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së bashkëkryetarit. Të përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së bashkëkryetarit. Të përcaktohet qartë në ligj kriteret e përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Komitetit.

Reflektuar në Kreun III të projektligjit.

5. Të parashikohet gjithashtu një strukturë me karakter teknik kompetente për të parë nga afër situatën dhe se sa të realizueshme janë dispozitat e parashikuara në ligj dhe në praktikë.

Sugjerimi është reflektuar.

❖ SHOQATA “SONCE”
SHOQATA KULTURORE “GORA”
SHOQATA “MOST” TË MINORITETIT ETNIK MAQEDONAS NË SHQIPËRI

Ka propozuar projektligj të ri.

Projektligji ka reflektuar një pjesë të mirë të sugjerimeve të projektligjit të propozuar nga këto shoqata.

❖ SHOQATAT E PAKICËS KOMBËTARE SERBO-MALAZEZE “JEDINSTVO”
DHE “SHEN JOVAN VLADIMIR”

Neni 3 të riformulohet:

“Një pakicë kombëtare është një grup shtetasish të Republikës së Shqipërisë të cilët (1), kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me territorin e shtetit shqiptar (2), shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, tradicionale, gjuhësore të njëjta mes tyre dhe të ndryshme nga shumica e popullsisë (3), dhe të cilët janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar së bashku, identitetin e tyre të dallueshëm kulturor, etnik, tradicional, gjuhësor ose fetar.

4.Pakicë kombëtare në kuptimin e këtij ligji është të grupet e shtetasve të cilat quhen dhe konsiderohen si popuj, etni , nacionalitete ose pakica linguistike të cilat përmbushin kushtet nga paragrafi 1 këtij neni.”

Formulimi i dispozitës në variantin përfundimtar përafrohet me propozimin e bërë.

Në nenin 5 të shtohen dy paragrafët me përmbajtje:

“ - Të dhënat e grumbulluara nga censusi mbi përkatësinë kombëtare të shtetasve transferohen në zyrat e gjendjes civile. Forma, përmbajtja, mënyra e ruajtjes dhe lëshimi i të dhënave personit të cilit i përkasin të dhënat mbi përkatësinë etnike, përcaktohet në ligjin i cili mbulon të dhënat e gjendjes civile dhe akteve ligjore dhe nënligjore të tjera fushës.

- Deri në miratimin e ligjit të ardhshëm të popullsisë dhe banesave, pjesëtarët e pakicave kombëtare mund të kryejnë regjistrimin provizor dhe marrjen e vërtetimit të përkatësisë së tyre kombëtare pranë zyrave të gjendjes civile me anë të një kërkesë.”

Formulimi i dispozitës përkatës në variantin përfundimtar përafrohet me propozimin e bërë duke përfshirë rolin e të dhënave në gjendjen civile për identifikimin e individëve që i përkasin pakicave.

Në nenin 9 të shtohet paragrafi me përmbajtje:

“Personat që i përkasin një pakice kombëtare të cilët kremtojnë festat fetare të parashikuara në kalendarin e Festave Zyrtare të Republikës së Shqipërisë sipas kalendarëve fetarë të ndryshëm, kanë të drejtën e marrjes së ditës së pushimit në datën e festës sipas kalendarit fetar të tyre.”

Thelbi i sugjerimit gjen reflektim në nenin 11 të projektligjit.

1. Në nenin 10(1) të shtohen nën-paragrafët si vijojnë:

“1.1 Garantohet për këtë qëllim pjesëmarrja e pakicave kombëtare të cilat zënë 1% në numrin e përgjithshëm të popullsisë në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë

1.2.Garantohet përfaqësimi proporcional i minoriteteve këshillat e njësive të administrimit vendor në njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, në përputhje me legjislacionin për pushtetin vendor dhe decentralizimin.

1.3 Garantohet përfaqësimi proporcional në organet e qeverisjes qendrore, vendore dhe në organet e drejtësisë në përputhje me raportin që pakicat kombëtare zënë në numrin e përgjithshëm të njësisë administrative-territoriale ku organi operon.

1.4 Me qëllim realizimin e të drejtave të parashikuara nga paragrafet 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni themelohen Këshillat Kombëtarë të Pakicave Kombëtare brenda këtyre organeve. Krijimi, funksionimi, përbërja dhe kompetencat e këtyre këshillave rregullohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave dhe të vetë organeve të qeverisjes vendore.”

Në lidhje me propozimet e lartpërmendura projektligji bën referimin tek legjislacioni përkatës për zgjedhjet dhe veprimtarinë e pushtetit vendor.

2. Në nenin 12(1) sugjerohet të shtohet fraza “në institucionet e arsimit parauniversitar në zonat ku ata banojnë.”

Në nenin 12(2) sugjerohet të shtohet fraza:

“Programi mësimor sipas paragrafit 1 të këtij neni do të përmbajë gjithashtu dhe elementet kulturës, historisë dhe traditave të pakicës kombëtare. Themelimi i institucioneve arsimore të pakicave kombëtare dhe mësimi i gjuhës amtare si dhe arsimimi mbi elementet e kulturës, historisë dhe traditave të pakicës kombëtare mund të realizohet edhe me një numër më të vogël nxënësish se numri i parashikuar për themelimin dhe arsimimin në institucionet arsimore në gjuhën shqipe.”

Sugjerimi 1 reflektuar në nenin 12(2). Sugjerimi 2 reflektohet në referimin tek ligji për arsimin parauniversitar si dhe do të reflektohet në aktet nënligjore përkatëse

3. Në nenin 14(1)(a) të shtohet “dokumentet personale në gjuhën amtare në alfabetin latin”.

Nuk gjendet e referuar në FCNM dhe as në legjislacionet e vendeve që janë konsultuar.

4. Në nenin 14(1)(c) të shtohet “gjuhën e tyre në procedurën gjyqësore dhe administrative”.

Parashikohet në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurave Administrative.

❖ SHOQATA BARAZI DHE INTEGRIM

1. Në nenin 1, termi “shoqëri e integruar” bie në kundërshtim me vet qëllimin e vetë ligjit. Të përdoret një term tjetër “Shoqëri gjithpërfshirëse”.

Sugjerimi i formulimit u bë nga Komiteti Shtetëror për Minoritetet.

2. Në nenin 3, përkufizimi duhet ti japë përparësi parimit të vetëidentifikimit dhe jo faktorëve jashtë individit. Ky përkufizim i kushton rëndësi vetëm faktorëve të jashtëm dhe jo vetëidentifikimit, si një nga parimet kryesore të konventës kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare.

Formulimi i dispozitës i jep përparësi elementit të vetëdeklarimit. Elementët e tjerë që plotësojnë kuadrin e identifikimit të përkatësisë së individit në një pakicë kombëtare bazohen në praktikën e vendeve europiane dhe synojnë të garantojnë një proces identifikimi real, transparent dhe ligjor.

3. Në nenin 17, të përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së bashkëkryetarit. Të përcaktohet qartë në ligj kriteret e përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Komitetit, dhe Komuniteti Egjiptian të njihet si komunitet i Pakicave Kombëtare dhe të ketë përfaqësuesin e tij në Komunitetin Shtetëror të Minoriteteve.

Sugjerimet gjejnë reflektim në Kreun III dedikuar Komitetit në projektligj. Bashkëkryetar është hequr si variant.

❖ SHOQATA BOSHNIJAKËT E SHQIPËRISË “ZAMBAK”

1. Në nenin 3 të shmanget përsëritja dy herë e termit “tradicional”.

Reflektuar.

2. Neni 12 “E drejta e arsimit në gjuhën e pakicës” të ketë më shumë hapësira bashkëpunimi me pakicat dhe vlerëson se ky nen është shumë i përgjithshëm dhe të gjitha kompetencat i lihen KM.

Do të plotësohet me aktet nënligjore duke qenë se projektligji ka natyrë kuadër.

3. Në lidhje me përdorimin e gjuhës, neni duhet të përcaktojë më mirë të drejtat e pakicës dhe me shumë përgjegjësi detyrimet e shtetit.

% mund të shkaktojë problem pasi mund të mos jetë reale duke marrë parasysh rezultatin jo realist të censusit të fundit.

Pragu është në përputhje me standardet europiane.

4. Sa i përket neneve 5 dhe 6 që kanë të bëjnë me identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave të censusit, parimisht nuk kemi asgjë kundër, por në realitet deri me sot ky element nuk ka funksionuar normalisht, të paktën për pakicat kombëtare të panjohura zyrtarisht deri më tani, siç është edhe komuniteti Boshnjak... Në këtë rast, nëse nuk preket projektligji, bëhet e domosdoshme që rregullimi të bëhet me dispozita kalimtare ose me akt nënligjor.

Do të rregullohen me akte nënligjore.

❖ FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Rekomandime kryesore:

a) Përkufizimi i pakicave kombëtare

i. Projektligji duhet të paraqesë koherencë gjuhësore dhe vijimësi të logjikës juridike sa i takon përkufizimit për pakicat kombëtare dhe aplikimit të këtij termi në nenet në vijim. Psh. Neni 7, pika b nuk përmend kategorinë '**identitet tradicional**'. Te **Neni 8, pika 1**, duhet të shtohet se ky ligj mbron dhe të drejtën për të shprehur **identitetin tradicional** krahas gjuhës dhe fesë.

ii. Krahas përkufizimit të përdorur deri tani në Projektligj, të shtohet dhe një paragraf tjetër, në të cilin të paraqiten nominalisht lista e pakicave kombëtare që njihen nga shteti shqiptar sikurse dhe të tjera të shfaqura në rezultatet e Censurit 2011. Në fund të paragrafit të shtohet “si dhe të gjitha ato pakica kombëtare që plotësojnë kriteret e parashikuara sipas paragrafit të parë të këtij neni” .

Reflektuar.

b) Komiteti i Pakicave Kombëtare

Neni 17, i cili parashikon krijimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare duhet të rikonceptohet si dhe të detajohen përbërja, propozimi dhe emërimi duke marr në konsideratë nivelin e legjitimitetit të përfaqësuesit të pakicës, kompetencat e Komitetit si dhe burimet financiare. Struktura duhet të pasqyrojë parimin e përfaqësimit të secilës pakicë kombëtare. Secila pakicë të ketë vende të përcaktuara në Komitet në proporcion me numrin e popullsisë së kësaj pakice. Anëtarët e Komitetit që përfaqësojnë pakicat propozohen nga Këshilli i Ministrave sipas një mekanizmi që siguron legjitimitet të kandidatëve dhe miratohen nga Kuvendi . Drejtimi i Komitetit të bëhet me anë të rotacionit, ku secila pakicë e përfaqësuar në Komitet të ketë një afat të barabartë bashkëdrejtimi me bashkëkryertarin nga radhët e Qeverisë .

Reflektuar pjesërisht. Riformulimi i ri nuk përfshin bashkëkryesues.

c) Kompetencat e Komitetit

i. Kompetencat kryesore të Komitetit, duhet të parashikohen në ligj duke synuar një rol aktiv në këshillimin për hartimin e politikave arsimore (përfshi dhe kurrikulat) dhe kulturore të cilat paraqiten për miratim pranë Këshillit të Ministrave. (subjekt ndryshimi neni 12, f. 3 dhe 4). Ministria e Arsimit duhet të ketë detyrimin të konsultohet me Komitetin për pjesët e kurrikulave që kanë për objekt trashëgiminë kulturore të pakicave kombëtare.

Sugjerimet gjejnë reflektim në variantin përfundimtar në përcaktimin e kompetencave të Komitetit.

ii. Në dispozicion të Komitetit të parashikohet një fond i vjetor, i cili të jetë në funksion të mbrojtjes ligjore të pjesëtareve të pakicave. Ky fond vihet në dispozicion të ndihmës juridike për komunitetet apo personat të cilët pretendojnë se janë diskriminuar për shkak të përkatësisë së tyre.

Është parashikuar në variantin përfundimtar.

iii. Të parashikohet në këtë Projektligj një Fond që të ketë si qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare. Fondi të jetë i hapur për aplikime çdo gjashtë muaj.

Është parashikuar në variantin përfundimtar.

a) Përfaqësimi në nivel vendor

Të shtohen dispozita ligjore ku të cilësohet se si pakicat kombëtare do të kenë mundësi reale të përfaqësohen në nivel vendor. Rekomandohet përdorimi i formulës së vendeve të rezervuara në Këshill Bashkiak për pakicat rome dhe egjiptiane. Nga kjo përfitojnë kandidatët që garojnë si të pavarur pjesë e këtyre pakicave të cilat përbëjnë së paku 1% të popullsisë në nivel të njësisë administrative ose kur popullsia e secilës pakicë (rome, egjiptiane) sipas Censurit zyrtar është më e madhe se 1,000 banorë. Ky propozim konsiderohet i domosdoshëm nisur nga niveli i lartë i diskriminimit dhe marginalizimit të këtyre pakicave si dhe duke patur në konsideratë të dhënat e Censurit të vitit 2011 i cili dëshmon përmasën e vogël të popullatës dhe një shpërndarje të theksuar gjeografike e cila e bën të pamundur përfaqësimin në qeverisjen vendore.

Është dhënë përgjigje në fq. 67.

b) Arsimi

Dispozitat e projektligjit që lidhen me sistemin arsimor duhet të theksojnë detyrimin e shtetit shqiptar për mbrojtjen dhe promovimin e identitetit dhe trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare duke obliguar ligjërisht Ministrinë e Arsimit të hartojë kurrikula shkollore të cilat të përbejnë lëndë të detyrueshme për të gjithë nxënësit në sistemin arsimor të detyrueshëm që kanë si subjekt të tyre njohjen dhe promovimin e diversitet kulturor. Ky detyrim ligjor, legjitimohet bazuar në qëllimin e këtij ligji për të ndërtuar një shoqëri ndërkulturore. Projektligji të kërkojë që ky detyrim ligjor të realizohet jo më vonë se dy vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Do të rregullohet me akt nënligjor.

c) Censusi

Të parashikohet në këtë *Projektligj*, zhvillimi i një censusi kombëtar i cili të ketë si qëllim kryesor krijimin e mundësisë për shprehjen e identitetit kombëtar. Kjo dispozitë ligjore ka legjitimitet përse kohë jemi para një ligji i cili ka avancuar në të konceptuarit e pakicave kombëtare dhe i ka dhënë më shumë mundësi pakicave kombëtare të shprehen për përkatësinë e tyre nëpërmjet kategorive si ajo e kulturës dhe identitetit tradicional. Pjesëtarë të pakicave kombëtare duhet të jenë anëtarë në komisionet/organet të cilat planifikojnë dhe menaxhojnë organizimin e Censurit si dhe të përfaqësohen në strukturën zbatuese të Censurit (anketues, mbikqyrës, koordinatorë etj).

Kërkesa duhet të gjejë referim tek ligji për regjistrimin e popullsisë

Rekomandime sipas neneve:

Në nenin 2(1) në vend të termit shoqëri e integruar, do të duhej të ishte 'shoqëri e hapur dhe demokratike'.

Referuar me lart

Neni 3(1) të rikonceptohet gjuhësisht dhe në vend që të thuhet “dalluese kulturore” të thuhet "anëtarët e pakicave kombëtare për shkak të dallimeve kulturore, identitetit tradicional". Qoftë dhe një prej këtyre dallimeve duhet të jetë kriter kualifikues për pakicat kombëtare.

Sugjerimi është në përputhje me formulimin dhe frymën e projektligjit (varianti përfundimtar)

Në nenin 7(2) të shtohet se mbrojtja kundër diskriminimit për shkak të përkatësisë (si pjesë e pakicës kombëtare) realizohet bazuar në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Përgjigje: Nuk mund të bëhej referimi tek ligji i sugjeruar nga pikëpamja e teknikës legjislative sepse mbrojtja kundër diskriminimit jo vetëm që parashikohet në Kushtetutë dhe në ligjin e posaçëm por dhe në një numër aktesh të tjera ligjore dhe nënligjore.

Projektligji dhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi janë komplementarë të njëri-tjetrit.

Në nenin 7(2)b është evituar termi *tradicional* apo *identitet tradicional* ku ndërkaq, ai shfaqet si kriter ligjor në përkufizimin e pakicës kombëtare në nenin "3". Ka shumë mundësi që këtu jemi para një lapsusi gjuhësor, por megjithatë nevojitet që kjo mangësi të adresohet.

Reflektuar.

Neni 7(2)(b) të rikonceptohet gjuhësisht si vijon, "mbrojtur personat që i përkasin pakicave kombëtare subjekte të këtij ligji nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre kolektiv".

Konceptet e sugjeruara janë të shprehura në projektligj.

Neni 8 të vërë theksin te liria e ndërgjegjes, mendimit, pa u përqendruar te e drejta e shfaqjes së fesë apo besimit, por në tërësi te liria si e drejtë për të shfaqur identitetin si individ dhe si komunitet (pakicë kombëtare).

Përgjigje: Reflektuar.

Në nenin 8(b), nuk del qartë se çfarë kuptohet me 'organizatë civile', kur ndërkohë baza ligjore që i referohet si rregullatore, është ligji për Partitë Politike në Republikën e Shqipërisë. Vetë ligji për organizmin e Partive Politike nuk na jep një kuptim për organizatat civile sikurse i kemi të përdorura në pikën 2 të nenit 8. Të qartësohet se përse bëhet fjalë, ndoshta është krejt e panevojshme përmendja e termit organizatë civile.

Nënkuptoheh organizata të shoqërisë civile.

Në lidhje me nenin 10, projektligji duhet të shprehet qartë:

1. Se si miratohen këto “masa dhe politikat e nevojshme”. Gjithashtu, duhet të sqarohet se kush ka pushtetin apo detyrimin t’i iniciojë këto masa.

Reflektuar

2. Të saktësohet në ligj se çfarë kuptohet me pjesëmarrje e pakicave kombëtare në jetën publike. Neni në fjalë duhet të ketë terma konkret.

3. Të saktësohen afatet ligjore për çdo hap të këtij procesi ose të jepen referenca ligjore se si do të rregullohet kjo mangësi.

4. Këshilli i Ministrave duhet të raportojë çdo vit pranë Kuvendit mbi masat dhe progresin e bërë në këtë fushë, dhe për këtë të vendosen afate ligjore se kur, dhe se si do të koordinohet puna me Komitetin.

Raportimi bëhet nga Komiteti, neni 18.

Në lidhje me nenin 11, projektligji duhet të sqaroje:

1. Procesin e miratimit të strategjive, programeve dhe planeve të veprimit. Pra të shprehet qartë kush ka tagrin dhe/apo detyrimin ligjor t’i iniciojë (strategjitë, planet, programet) si dhe të qartësohet procesi nga inicimi deri tek zbatimi, duke saktësuar afatet dhe institucionet përkatëse me theks rolin që duhet të ketë Kuvendi.

2. Këshilli i Ministrave raporton çdo vit mbi progresin e masave para Kuvendit.

Përgjigje: Dispozita ka karakter të përgjithshëm duke specifikuar institucionet propozuese dhe miratuese sipas fushave të kompetencës.

Në nenin 12 (4)(5), të artikuloohen qartë afatet dhe instrumentat ligjor konkretë të cilët do të duhej të mundësonin vënien në zbatim të këtij neni si dhe gjuha e përdorur është shumë evazive.

Përgjigje: Reformular në përputhje me sugjerimin. Instrumenti ligjor është shumë i qartë: Vendim i Këshillit të Ministrave. Afatet ligjore për vendimet parashikohen në Rregulloren e Këshillit të Ministrave.

2. Të qartësohet se çfarë kuptohet me termin "masa të përshtatshme".

3. Të parashikoj detyrimin ligjor të Ministrisë së Arsimit për hartimin e kurrikulave të cilat të përmbajnë lëndë për trashëgiminë kulturore të pakicave kombëtare, për të gjithë nxënësit e sistemit arsimor të detyrueshëm.

Përgjigje: Masa të përshtatshme i referohet procedurave që lidhen me zbatimin të dispozitës. Sugjerimi i pikës 3 është shumë i detajuar dhe nuk mund të përfshihet në një dispozitë ligjore por duhet të parashikohet në legjislacionin detyësor që do të hartohet në

përputhje me standardet europiane dhe duke pasur parasysh kërkesat e grupeve të interesit.

Sugjerime për Nenin 17:

1. Të saktësohet numri i anëtarësisë ose së paku formula e përfaqësimit. Të shprehet qartë për raportin e pushtetit dhe vendimmarrjes në mes *bashkryetarëve* të Komitetit si dhe balancat e numrave midis përfaqësuesve të pakicave dhe përfaqësuesve të organeve shtetërore (formula e përfaqësimit). Mund të zbatohet një formulë përfaqësimi që aplikon kriterin e përqindjes në shkallë vendi të pakicës kombëtare.

2.

i. Të dekurajohet që propozimi i kandidaturës së bashkë kryetarit që përfaqëson pakicat të bëhet nga Kryeministri, dhe tu jepet si mundësi komuniteteve të pakicave kombëtare për ta pasur drejtimin e plotë të Komitetit, nëpërmjet formulës së rotacionit, sipas së cilës çdo ‘pakicë kombëtare’ ka të drejtë të bashkë kryesojë Komitetin për një periudhë të përcaktuar qartë në këtë ligj.¹

ii. Alternativa e dytë: të aplikohet formula e drejtimit me bashkëkryetar. Bashkëkryetari nga pakicat përcaktohet me anë të rotacionit, ku secila pakicë e përfaqësuar në Komitet të ketë një afat të barabartë bashkëdrejtimi me bashkëkryetarin nga radhët e Qeverisë. Si model për formulën e përfaqësimit dhe rotacionit mund të merret ai që është aplikuar në Kosovë.

iii. Kandidaturat për anëtarë që përfaqësojnë pakicat kombëtare në Komitet propozohen fillimisht Këshillit të Ministrave nga dy burime a) Të paktën tre organizata të regjistruara në Gjykatë, b) Kandidatura mbështetet me të paktën 1000 firma të mbledhura nga anëtarë të pakicës përkatëse. Këshilli i ministrave shqyrton kandidaturat dhe dërgon në Kuvend për miratim kandidatët sipas numrit të vendeve në Komitet për secilën pakicë kombëtare. Në rast të mos miratimit të kandidaturave, Këshilli i Ministrave propozon kandidatë të tjerë.

4.

i. Komiteti të ketë në dispozicion një fond vjetor i cili përcaktohet nga qeveria në buxhetin vjetor. Fondi të jetë i hapur për aplikime çdo gjashtë muaj. Projektet të kenë në fokus mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare. Të drejtën për të aplikuar ta kenë vetëm anëtarët/organizatat e pakicave kombëtare. Të drejtën e miratimit të fondit ta ketë Komiteti ose një komision i krijuar nga Komiteti enkas për këtë qëllim.

ii. Në dispozicion të Komitetit të parashikohet një fond i vjetor, i cili të jetë në funksion të mbrojtjes ligjore të pjesëtarëve të pakicave. Ky fond vihet në dispozicion të ndihmës juridike për komunitetet apo personat të cilët pretendojnë se janë diskriminuar për shkak të përkatësisë së tyre.

iii. Komiteti ka në strukturën e vetë staf administrativ i përqendruar në fushat kryesore të projektligjit (Arsimi, Trashëgimia Kulturore, Përfaqësimi dhe Mbrojtja nga Diskriminimi), i cili ndihmon në përmbushjen e rolit të tij.

¹ Psh sipas modelit të Kosovës,

5. Kompetencat kryesore të Komitetit:

- I propozon Këshillit të Ministrave politika dhe masa në funksion të zbatimit të këtij ligji;
- Dërgon rekomandime pranë Ministrive të linjës, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit lidhur me projektligje dhe ligje të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në zbatimin efektiv të këtij ligji;
- Vë në lëvizje Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatin e Popullit për raste kur e vlerëson si të arsyeshme;
- Mbikëqyr zbatimin e këtij ligji dhe raporton një herë në vit pranë Kuvendit për progresin në fushën e mbrojtjes së pakicave kombëtare;
- Merr pjesë në strukturën e organizimit të Censurit përmes anëtarëve të tij të cilët zgjidhen me shumicë të thjeshtë nga anëtarësia e Komitetit;
- Administron Fondin për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare i cili shpërndahet përmes garës transparente dhe parimit të proporcionalitetit;
- Administron Fondin për ndihmën juridike për mbrojtjen nga diskriminimi;

Zbërthimi i kompetencave kryesore bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave

**❖ PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE ROME
“IRCA”; “RAA”; ORGANIZATA “USHTEN”; “RËRC”; “LRER”; UNIONI I
ROMËVE PËR INTEGRIM “AMARO DROM”; QENDRA “RROMANI BAXT”;
SHOQATA GRUAJA ROME E SË NESËRMES; SHOQATA “DISUTNI
ALBANIA”; ROMA VERSITAS ALBANIA; ROMA VOICE IN ALBANIA;
RRJETI I STUDENTËVE DHE TË DIPLOMUARVE ROM**

Projektligji të përmirësohet duke adresuar çështjet e mëposhtme:

1. Garantimi i Statusit Kushtetues të Ligjit për Pakicat Kombëtare;
2. Njohja de jure si ‘pakica kombëtare’ e të gjitha pakicave të njohura de facto dhe të përfaqësuara në Komitetin Shtetëror të Minoriteve ekzistues;
3. Njohja e statistikave plotësuese (krahas statistikave të censurit) dhe e dëshmive të anëtarësisë në organizatat joqeveritare të pakicave për identifikimin individual të personave që u përkasin pakicave;
4. Institucionalizimi i dialogut me organizatat joqeveritare të pakicave në të gjitha nivelet e qeverisjes;
5. Ndalimi i të gjitha formave të diskriminimit dhe i gjuhës së urrejtjes ndaj pakicave në media dhe nxitja e marrëdhënieve miqësore ndërkulturore në të gjitha platformat mediatike përfshirë edhe ato online;
6. Mbrojtja e barabartë nga ligji nëpërmjet parandalimit dhe luftës kundër marginalizimit social-ekonomik dhe garantimit të mundësive të barabarta;
7. Garantimi i përfaqësimit politik dhe pjesëmarrjes efektive në administratën publike;
8. Komitetit Shtetëror për Pakicat Kombëtare me Zyrat Shtetërore për çdo pakicë duhet të përfaqësoj angazhimin kushtetues të shtetit për mbrojtjen e minoriteteve dhe si i tillë duhet t’i garantohet pavarësia;
9. Krijimi i Fondit për Marrëdhëniet Ndërkulturore.

Në bazën ligjore të projektligjit sugjerojnë të listojnë 11 akte ndërkombëtare në kuadër të OKB-së dhe KiEs.

Formulimi aktual është në përputhje me teknikën legjislative.

Sugjerohet që projektligji të titullohet “Ligj Kushtetues....”

Projektligji nuk ka natyrë kushtetuese nga pikëpamja e hierarkisë së normave.

Nenit 1 ti shtohet fraza “dhe instrumentet ndërkombëtar që mbrojnë të drejtat e pakicave kombëtare”.

Reflektuar duke u bërë më garantues “...në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut ku Republika e Shqipërisë është palë”.

Nenit 2 ti shtohet një paragraf i 3-të me përmbajtje “*Ky ligj kushtetues orienton plotësimin e legjislacionit zbatues sipas fushave përkatëse të tilla si arsimit, parandalimi dhe lufta ndaj marginalizimit social-ekonomik, trashëgimia kulturore, media, përfaqësimi politik, pjesëmarrja në administratën publike, dhe çdo fushë tjetër përkatëse. Kontrolli i përputhshmërisë së legjislacionit zbatues me këtë ligj kushtetues garantohet nga Gjykata Kushtetuese.*”

Konceptet e sugjeruara reflektohen në dispozitat e projektligjit por shtesa e sugjeruar nuk është formuluar sipas kërkesave të teknikës legjislative.

Nenit 3 ti shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Pakicat pjesëmarrëse në Komitetin Shtetëror të Minoriteteve përpara miratimit të këtij ligji kushtetues njihen automatikisht pa asnjë dallim si pakica kombëtare. Pas miratimit të ligjit, kërkesat për njohjen e pakicave kombëtare shqyrtohen nga Komiteti Shtetëror për Pakicat Kombëtare i cili paraqet rekomandimet përkatëse Këshillit të Ministrave.”

Projektligji identifikon të gjitha pakicat kombëtare ndërkohë që tagrin për propozimin e njohjes së pakicave të reja e ka Këshilli i Ministrave me iniciative të Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila administron Regjistrin e Gjendjes Civile.

Në nenin 5 sugjerohet të shtohen paragrafët e mëposhtëm:

“-Përveç statistikave mbi pakicat kombëtare të gjeneruara nga rregjistrimi periodik i popullsisë, autoritetet publike marrin në konsideratë statistika plotësuese nga burime alternative të besueshme përse kohë tregohet se këto statistika plotësuese janë gjeneruar nëpërmjet metodologjive dhe standardeve të njohura kërkimore dhe nuk janë mbledhur në kundërshtim me ligjin.

- Identifikimi individual i përkatësisë në një pakicë kombëtare, për të mundësuar gëzimin efektiv të të drejtave specifike nga individët përkatës, bëhet nëpërmjet dëshmisë së anëtarësisë në ndonjërin prej organizatave joqeveritare të pakicave, sipas një formati të unifikuar nga Zyra Shtetërore e pakicës përkatëse pranë Komitetit Shtetëror për Pakicat Kombëtare.

- Asnjë autoritet publik nuk mund të detyrojë një person të deklarojë me shkrim apo verbalisht përkatësinë në ndonjë pakicë kombëtare përveç rasteve të parashikuara në ligj.”

Një pjesë e sugjerimeve janë të reflektuara ndërsa një pjesë do të gjejnë trajtim në aktet nënligjore.

Neni 7 të riformulohet me propozimet si vijojnë:

“Ndalimi i diskriminimit [ngacimit⁴ dhe gjuhës së urrejtjes]

1. [Të gjithë individët janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtën e mbrojtjes së barabartë nga ligji pa diskriminim.]

2. Çdo diskriminim [, nxitje e diskriminimit, armiqësisë apo dhunës, shqetësimit/ngacimit, viktimizimi, përdorim i gjuhës së urrejtjes, kërcënim apo ushtrim i dhunës] ndaj çdo personi për shkak të përkatësisë në një pakicë kombëtare është i ndaluar [dhe sjell përgjegjësi civile, administrative dhe penale sipas legjislacionit përkatës.]

3. [Përgjegjësia për veprimet dhe mosveprimet e ndaluara më sipër sipas rastit bie mbi personat privat, personat juridik privat, individët e zgjedhur apo të emëruar në institucionet publike, si dhe vetë institucionet publike, mediat e shkruara dhe radio-televizive, operuesit dhe zotëruesit e mediave sociale dhe ëeb-faqeve.]

4. Institucionet publike, në nivel qendror dhe vendor [me rekomandim të Komitetit Shtetëror për Pakicat Kombëtare dhe në konsultim të ngushtë me organizatat joqeveritare të pakicave kombëtare përkatëse] miratojnë të gjitha masat e nevojshme për të:

a) promovuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës;

b) të mbrojtur personat që i përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia, [gjuha e urrejtjes, ngacimi, viktimizimi] apo dhuna për shkak të identitetit të tyre etnik, kombëtar, kulturor, gjuhësor ose fetar;

c) forcuar dialogun ndërkulturor;

d) nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit kombëtar, kulturor, gjuhësor apo fetar.

5. Masat e miratuara në përputhje me paragrafin 2 [dhe çdo masë e nevojshme tjetër e ndërmarr nga autoritetet publike ose personat juridik privat në favor të një personi apo grupi personash që u përkasin pakicave kombëtare me synim ofrimin e shanseve të barabarta dhe mbrojtjen e grupeve të disavantazhuar] nuk përbëjnë akte diskriminimi.”

Sugjerimet trajtohen si nga projektligji ashtu dhe nga ligji për ndalimin e diskriminimit.

Neni 8 t'i shtohet në titull edhe fraza “...dhe e drejta e përfaqësimit”. Si dhe në paragrafin 3 të përcaktohet e drejta e përfaqësimit të garantuar dhe pjesëmarrjes në grupime politike.

Përveç garancive që jep projektligji këto garanci jepen dhe nga ligji për partitë politike.

Në nenin 10(1)(3)(4) sugjerohen:

“1. ...Në veçanti në [u garantohet pjesëmarrja efektive në strukturat e administratës publike, institucionet gjyqësore, organet e zbatimit të ligjit si dhe institucione të tjera përgjegjëse për]

çështje të rëndësishme për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e kulturës, traditat dhe identitetin e pakicës të cilës ata i përkasin.

3.

Këshilli i Ministrave [*me rekomandim të Komitetit Shtetëror për Pakicave Kombëtare dhe në konsultim të ngushtë me organizatat joqeveritare të pakicave kombëtare përkatëse*] miraton masat dhe politikat e nevojshme për të [*parandaluar dhe luftuar marginalizimin social-ekonomik si dhe*] siguruar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike, duke siguruar mekanizmat dhe [*garantuar burimet e nevojshme financiare në ligjet vjetore të buxhetit të shtetit*].

4. [*Njësitë e qeverisjes vendore me rekomandim të Komitetit Shtetëror për Pakicat Kombëtare dhe në konsultim të ngushtë me organizatat joqeveritare të pakicave kombëtare përkatëse hartojnë strategji lokale, plane veprimi dhe garantojnë burimet e nevojshme financiare në buxhetet lokale vjetore për të parandaluar dhe luftuar marginalizimin social-ekonomik si dhe siguruar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike.*]

Sugjerimet gjejnë trajtim në dispozitat përkatëse të projektligjit dhe do të shtjellohen me aktet nënligjore.

Në nenin 11(2)(3) sugjerohen shtesat si vijon:

“[2. *Individët dhe personat juridik që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të krijojnë, manaxhojnë, dhe mbështesin funksionimin e institucione kulturore private.*]

3. Këshilli i Ministrave [*me rekomandim të Komitetit Shtetëror për Pakicat dhe në konsultim të ngushtë me organizatat joqeveritare të pakicave kombëtare përkatëse*] miraton strategji, programe dhe plane veprimi [*dhe garanton burimet e nevojshme financiare duke parashikuar linjë të vecantë buxheti në ligjet vjetore të buxhetit,*] për të nxitur kushtet e nevojshme për të ruajtur dhe zhvilluar identitetin e pakicave kombëtare.”

Sugjerimet gjejnë trajtim në variantin përfundimtar.

Në nenin 12(2)(3)(4)(6) sugjerohen shtesat si vijon:

“2. Personave që i përkasin pakicave kombëtare, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ato banojnë tradicionalisht apo në numër thelbësor, u sigurohen mundësi të përshtatshme për të mësuar ose për të marrë mësim në gjuhën e pakicës, [*sipas nevojave të vecanta të çdo pakice kombëtare*] nëse ka një kërkesë të mjaftueshme dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.

3. Këshilli i Ministrave [*me rekomandim të Komitetit Shtetëror për Pakicat dhe në konsultim të ngushtë me organizatat joqeveritare të pakicave kombëtare përkatëse*] miraton masat e përshtatshme në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor me qëllim nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare dhe të shumicës.

4. Këshilli i Ministrave [*me rekomandim të Komitetit Shtetëror të Pakicave dhe në konsultim të ngushtë me organizatat joqeveritare të pakicave kombëtare përkatëse*] miraton masat e përshtatshme për krijimin e mundësive dhe kushteve për pajisjen me tekste shkollore, miratimin e kurrikulave dhe trajnimin e mësuesve, si dhe për krijimin dhe funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.

6. ... [*Pa çënuar masat për ruajtjen e identitetit të pakicave kombëtare, autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin për të siguruar mësuesë të kualifikuar, kurrikula dhe tekste mësimore të*

përshtatshme të hartuara me qëllim mësimin e gjuhës shqipe në të gjitha nivelet para-universitare, duke marr në konsideratë nevojat specifike të cdo pakice kombëtare.]”

Në nenin 13 të ndryshohet emërtimi i titullit, i cili nuk është pranuar pasi titulli aktual është në përputhje me FCNM.

Në nenin 13(2) sugjerimi për reflektimin e frazës “kanë të drejtën e ofrimit të shërbimeve” është pranuar duke u bërë “kanë të drejtën e përdorimit të shërbimeve”.

Neni 13(4)(5) të ndryshohen si vijon:

“4. Institucionet përgjegjëse krijojnë kushtet e përshtatshme dhe garantojnë burimet e nevojshme financiare për t’i siguruar pakicave akses efektiv në median e shkruar dhe elektronike, në zbatim të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

5. Autoriteti monitorues i mediave garanton zbatimin e aksesit efektiv të pakicave në media, nxit transmetimet që promovojnë harmoninë ndërkulturore, si dhe monitoron ndalimin e gjuhës diskriminuese dhe përçmuese ndaj personave që u përkasin pakicave në përputhje me nenin 7 të këtij ligji dhe dispozitat e tjera ligjore përkatëse.”

Nevojitet të bëhet rregullimi në ligjin përkatës për mediat audiovizuale duke qene se projektligji kuadër jep garancitë e përgjithshme.

Në nenin 14(5) të shtohet fraza “...[*të drejtën të asistohet*] për të mbrojtur veten e tij/saj në këtë gjuhë, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.”

Referohet në KPP.

Sugjerohet ndryshimi thelbësor i nenit 17/a si vijon:

“Institucionet Përgjegjëse

1. Këshilli i Ministrave, ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore janë institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

2. Gjykata Kushtetuese në përputhje me kompetencat dhe procedurat e përkatëse bënë kontrollin e përputhshmërisë së legjislacionit zbatues me ligjin kushtetues për pakicat kombëtare.

*3. Krijohet Komiteti **Shtetëror** për Pakicat Kombëtare (në vijim “Komiteti”), [i cili vepron si institucion i pavarur me qëllim monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të këtij ligji në nivel qendrorë dhe vendor.*

a. Komiteti Shtetëror për Pakicat Kombëtare përbëhet nga Zyrat Shtetërore për secilën pakicë dhe kryesohet nga një Kryetar i cili përfaqëson Komitetin dhe zgjidhet nga Kuvendi me propozim të Kryeministrit pasi është nominuar më parë nga organizatat joqeveritare të pakicave.

b. Anëtarët e Komitetit përfaqësojnë Zyrat Shtetërore për Pakicën përkatëse që funksionojnë brenda Komitetit. Anëtarët e Komitetit drejtojnë secilën prej zyrave përkatëse emërohen nga Kryeministri pasi janë nominuar nga organizatat joqeveritare të pakicave përkatëse. Anëtarët e Komitetit veprojnë kolegjisht nën drejtimin e Kryetarit dhe nëpërmjet Zyrave të veçanta për çdo pakicë të cilat ndjekin çështjet sipas specifikeve përkatëse.

c. Për mbarëvajtjen dhe funksionimin efektiv të tij, Komiteti dhe Zyrat për çdo pakicë duhet të mbështeten nga një strukturë administrative në nivel qendror dhe prefekturë me specialistë që ndjekin problematikat e veçanta për cdo pakicë kombëtare.

d. Zyrat Shtetërore për cdo pakicë krijojnë marrëdhënie dialogu institucional me organizatat joqeveritare të pakicave përkatëse dhe lehtësojnë rrjetësimin e tyre për çështje që lidhen me zbatimin e këtij ligji.

e. Zyrat Shtetërore për cdo pakicë monitorojnë dhe koordinojnë zbatimin e ligjit duke bashkërenduar punën me ministrinë e linjës (në nivel Zv.Ministri) dhe njësitë e qeverisjes vendore (në nivel Zv.Kryetari Bashkie).

f. Komiteti është i pavarur në ushtrimin e detyrës së tij dhe nënshtrohet vetëm kushtetutës dhe ligjeve. Komiteti ka buxhetin e vet të pavarur, dhe financohet nga buxheti i shtetit dhe donacione të ndryshme. Struktura, funksionet dhe buxheti i Komitetit dhe roli i Zyrave Shtetërore për cdo pakicë miratohet nga Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave në konsultim të ngushtë me organizatat e joqeveritare të pakicave.]

Të shtohet Neni 17/b me këtë përmbajtje:

“Fondi për Marrëdhëniet Ndërkulturore

1. Krijohet Fondi për Marrëdhëniet Ndërkulturore. Fondi miratohet si zë i veçantë në buxhetin e shtetit për mbulimin e të gjitha shpenzimeve financiare vjetore që burojnë nga zbatimi i këtij ligji.

2. Ministria e Financave në konsultim me Komitetin Shtetëror për Pakicat Kombëtare është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Fondit për Marrëdhëniet Ndërkulturore.”

Kreu III për Komitetin parashikon kompetencat, përbërjen si dhe ngritjen e një Fondi për Pakicat.

❖ GRUPI SHQIPTAR I TË DREJTAVE TË NJERIUT

1-Në përgjithësi, ligji ka një natyrë evasive dhe të përgjithshme. Në dukje, nenet përkatëse duket se i kanë ezauruar të gjitha problemet dhe shqetësimet që kanë minoritetet në Shqipëri, por nga ana tjetër ato kanë një frymë të sipërfaqshme dhe disa temave qendrore dhe të rëndësishme, iu kalojnë shkarazi. Kjo duket sidomos në nenet që i përkasin çështjeve të Edukimit, Gjuhës, Përfaqësimit, Mediave, Censurit, etj.

2-Sidomos e drejta e arsimit në gjuhën e pakicës, e përdorimit të gjuhës, të drejtat kulturore dhe fetare, liria e shprehjes, e drejta e përfaqësimit, raportet e ndërsjellta me median, janë shprehur të paplota në projektligj dhe mendojmë se ka nevojë të rishkruhen. Si i tillë, ligji duhet të përmbajë më shumë nene se këto ekzistuese.

3-Projektligji ka një frymë disi centralizuese; kompetencat e Kryeministrit sidomos në nenet 10 dhe 11 janë të tejkaluara, ndërkohë që në këtë rast, mund t’i jepej një rol dhe rëndësi me e madhe Komitetit të Pakicave Kombëtare.

4-Neni 3– Përkufizimi. Mendojmë se ka nevojë për një përcaktim më të mirë. Në frazën : “...shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, tradicionale, gjuhësore ose fetare ...-mendojmë të shtohet fraza: “të ndryshme nga shumica”.

5-Neni 5– Identifikimi. Ka nevojë të qartësohet më shumë e drejta e vetëdeklarimit. Ligji duhet të përcaktojë mundësira më fleksibël për vetëdeklarim të individëve të pakicave.

6-Neni 11/3, duhet qartësuar shumë mirë sepse ka rrezik të keqinterpretohet dhe të keqimplementohet.

7-Neni 13/2, mendojmë të zëvendësohet fraza “...personat që i përkasin pakicave kombëtare do të kenë mundësinë ...” me “kanë të drejtë të përfitojnë shërbimet....”

Reflektuar.

8-Neni 14/3: “Me vendim të këshillave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, kur ka një kërkesë të mjaftueshme, në njësitë e vetëqeverisjes vendore/njësitë administrative ku 20% e banorëve i përkasin pakicave kombëtare, emërtimet e njëjësive administrative përkatëse, rrugëve dhe treguesve të tjerë topografikë, krahas gjuhës shqipe, shfaqen dhe në gjuhën e pakicës përkatëse, sipas parashikimeve ligjore për vetëqeverisjen vendore”.

Në po këtë Nen, shprehja “kërkesë e mjaftueshme”, është e paqartë dhe mund të keqzbatohet. T’iu respektohet të drejtën minoriteteve, nuk ka nevojë të presësh për kërkesa të mjaftueshme, etj. Gjithashtu, folja “shfaqen”, mendojmë se është e pavend në këtë nen. Në të kundërt neni duhet ta bëjë të zbatueshëm automatikisht veprimin e emërimit të rrugëve, etj.

9-Roli i Komitetit të Pakicave në ligj, është shumë i vogël dhe i paplotë. Kjo pjesë ka nevojë për një rishikim shumë impenjues, ku Komitetit të Pakicave, i duhet dhënë një rol i përcaktuar qartë, informues, zbatues, koordinues, etj.

Shqetësimi është reflektuar me hartimin e Kreut III për Komitetin.

10-Projektligji nuk ka parashikuar asnjë buxhet, i cili duhet të vihet në dispozicion të shumë shërbimeve që shteti duhet t’iu përmbushë pakicave.

Është parashikuar krijimi i Fondit për Pakicat, neni 20.

11-Në projektligj mungojnë definicionet.

Neni 3 i projektligjit përkufizon pakicat kombëtare.